

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6049
E hënë, 29 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Presidenti Thaçi sot në orën 20:00 paraqitet para publikut | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", NASIM HARADINAJ | FAQE 4-5

GJYKATA SPECIALE VËRTETOI PRETENDIMET TONA SE ËSHTË POLITIKE



Nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj, ka vlerësuar se Gjykata Speciale ka vërtetuar se është gjykatë kryekëput politike. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se me publikimin e propozi-

maktakuzës ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit kjo gjykatë i ka konfirmuar pretendimet e OVLUÇK-së. Ai ka treguar se publikimi i propozimaktakuzës pa u konfirmuar dhe pak ditë para mbajtjes së takimit të Uashingtonit ndërmjet

Kosovës dhe Serbisë ka qenë veprim dashakeqes. Haradinaj ka ftuar spektrin politik që të bashkohet për këtë çështje. Ai ka deklaruar se OVLUÇK-ja nuk do t'i ndalë përpjekjet për ta zhbërë këtë gjykatë

OPINION



I NDERUAR PRESIDENT, QËNDROJ PRANË FIGURËS SUAJ | F. 11

Ekrem BARDHA

AKTUALE

PROVOKOJNË SERBËT NË GAZIMESTAN, DY PREJ TYRE SHOQËROHEN NË POLICI | F. 6

MBI 100 PACIENTË ME COVID-19 TË SHTRIRË NË KLINIKËN INFEKTIVE, 4 NË GJENDJE TË RËNDË | F. 7

EKONOMI



OEAQ-u: LUFTA E BRENDSHME POLITIKE PO RREZIKON NËDËRMARRJET DHE VENDET E PUNËS NË KOSOVË | F. 9

BIZNESET KËRKOJNË SHTYRJEN E PAGESËS SË KREDIVE EDHE PËR TRE MUAJ | F. 8

SPORT

DRITA NUK GABON NDAJ DUKAGJINIT | F. 18



Hoti: Shkaku i rritjes së rasteve me Covid-19 mund t'i rikthejmë masat e izolimit

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Gjermania kufizon fuqinë punëtore nga Ballkani pas rritjes së numrit të të papunëve vendës

BERLIN, 28 QERSHOR - Gjermania do t'i vendosë kufizime fuqisë punëtore nga Ballkani pasi që numri i të papunëve në këtë vend ka shënuar rritje si pasojë e pandemisë Covid-19. Zëdhënësi i koalicionit CDU/CSU për Politika të Brendshme në

Bundestag, Mathias Middelberg, ka thënë për gazetën gjermane "Welt am Sonntag" se ky shtet ka shënuar rënie të madhe ekonomike dhe se tani janë 600 mijë të papunë më shumë sesa para një viti. "Në një gjendje të tillë,

mosndryshimi i rregullores për Ballkanin Perëndimor nuk përbën opsion. Prandaj po bëjmë fushatë për kufizim të qartë të rregullores: dy në vend të pesë vjetëve dhe një kuotë vjetore prej më së shumti 15 000 vetash", ka thënë ai.



Kryetari Leli: Vlora ka pësuar transformim rrënjësor, shpresoj që do të rimëkëmbet sektori i turizmit

VLORE, 28 QERSHOR - Plazhet mahnitëse të qytetit historik të Vlorës po presin me padurim turistët dhe pushuesit e parë ani pse këtë vit pritjet që shumica prej tyre të jenë turistë vendës. Ndonëse pandemia Covid-19 ka pllakosur gjithë botën, sektori më i dëmtuar mbetet turizmi. Për këtë udhëheqësi i Bashkisë së Vlorës, Dritan Leli, ka bërë thirrje që shqiptarët nga Kosova të vizitojnë këtë vend dhe të ndihmohet rimëkëmbja ekonomike. Leli ka thënë se pandemia ka dëmtuar mjaft shumë sektorin e turizmit, derisa ka shtuar se janë duke u bërë përpjekje për t'i ndihmuar bizneset e Vlorës. "Sigurisht pandemia, pjesë shoqëruese e jetës tanimë e cila ka pllakosur gjithë planetin, ka shkaktuar problemet e saj, sidomos në sektorin e shërbimeve, në sektorin turistik, prandaj të gjithë së bashku jemi duke u përpjekur që t'ua japim ndihmesën e duhur të gjitha këtyre bizneseve të cilat prej pandemisë kanë pësuar dëme të konsiderueshme. Mund të themi që prej pjesës të gjithë karantinimit, të gjitha bizneset e shërbimeve, të gjitha bizneset e vendosura në territorin e Bashkisë së Vlorës kanë qenë të mbyllura", ka thënë Leli. Pas daljes nga karantina, Leli ka



thënë se bizneset kanë filluar të rimëkëmben dhe sektori i turizmit të zhvillohet. "Të gjitha rastet që identifikohen me Covid-19 në gjithë territorin kanë një përkujdesje të veçantë të njësive shëndetësore në qytet, të cilat janë tanimë në gjurmim të çdo rasti kontakti në mënyrë që ta ndalojnë përhapjen dhe rastet në Vlorë gjatë kohës së karantinës ishin shumë pak, një në pesë raste. Ndërkohë që tani, për arsye të

lëvizjes, kemi një shtim të rasteve, jo shumë të konsiderueshëm, për të na trembur apo për të na bërë që ta ndryshojmë sjelljen dhe ta ndryshojmë strategjinë", ka thënë ai për "KosovaPress", duke shprehur optimizëm se sektori i turizmit do të rimëkëmbet shpejt. "Unë them që pavarësisht dëmtimit që ka ndodhur në territorin në muajt që ka qenë në pushim, ajo që kam shpresë është se, duke qenë që njësitë

ose industria e turizmit në territor është e vogël, nuk ka ata mekanizmat e hoteleve gjigante me shumë shtretër, por është për hotelet butikë, hotelet që kanë pak persona dhe që mund të rimëkëmben shumë shpejt dhe të vihen në funksionalitet. Të gjitha këto më japin shpresë, ndihem pozitiv që do të ketë një ngritje ditë pas dite të biznesit të turizmit në territor", ka thënë Leli. Më tutje, ai ka shtuar se vitin e

kaluar ka përfunduar dhe bulevardi "Ismail Qemali", që është shndërruar në destinacionin më të bukur të qytetit, duke ua rekomanduar qytetarëve të Vlorës dhe vizitorëve. "Është një nga destinacionet më të rëndësishme turistike të Shqipërisë. Ka pësuar një transformim rrënjësor kryesisht në investimet e fundit të infrastrukturës. Ne kemi realizuar në këta katër vjet. E kemi bërë një qytet tjetër. Lungomare fantastike është një nga investimet e fundit të infrastrukturës. Çdo kush mund të kalojë orë me fëmijët, të shëtisë, ta shijojë plazhin, t'i shfrytëzojë baret apo restorantet. Pakkush sa shqiptarët e Kosovës do ta kenë ndjesinë pozitive të shëtisur në bulevardin me emrin e madh të Ismajl Qemalit të rikonstruktuar", është shprehur Leli. Ata që duan ta gjejnë lidhjen me historinë e Skënderbeut, Leli ka thënë se mund të shkojnë në Kaninë, e të tjerët në Lagunën e Manastirit. Dritan Leli ka theksuar se gjatë këtij sezoni rëndësi do t'i jepet respektimit të masave të marra nga qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë, duke i ndjekur ato në mënyrë rigorozë që pushuesit të ndihen të sigurt në Vlorë.

Anastas Janullatos bën ndërhyrje në zemër, Meta i uron shërim të shpejtë

TIRANË, 28 QERSHOR - Kryepeshkopi Anastas Janullatos i është nënshtruar një ndërhyrje në zemër të premtën në një spital privat në kryeqytet. Janullatos ka vendosur dy stenda në zemër dhe Kryepeshkopata ka njoftuar se ndërhyrja është realizuar me sukses. Kryepeshkopata ka thënë se Anastas Janullatos është në gjendje të kënaqshme dhe se për dy ditë kthehet në Kryepeshkopatë. "Kryepeshkopi i Tiranës,

Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e tij, Anastasi, u shtrua në një spital privat në Tiranë për shkak të shqetësimeve cardiace. Pas ekzaminimeve, u konstatua stenoze e arteries së zemrës dhe brenda ditës u realizua me shumë sukses ndërhyrja angioplastike, me vendosjen e dy stentave. Lavdi Zotit, sot, ditën e shtunë, shëndeti i tij paraqitet veçanërisht i kënaqshëm. Mjekët e informuan se brenda dy ditësh



do të jetë në gjendje të kthehet në Kryepeshkopatë", ka njoftuar Kryepeshkopata. Lidhur me këtë zhvillim ka reaguar edhe presidenti Ilir

Meta, i cili i ka uruar kryepeshkopit Anastas rikthim sa më të shpejtë në krye të detyrës së tij tepër të rëndësishme. "Duke i shprehur urimet e mia më të mira e të përzemërta për shëndet të plotë dhe jetë të gjatë kryepeshkopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Anastas Janullatos, ndaj kënaqësinë që pas ndërhyrjes angioplastike shëndeti i Tij paraqitet i kënaqshëm. I uroj kryepeshkopit Anastas

rikthim sa më të shpejtë në krye të detyrës së tij tepër të rëndësishme. Një falënderim të veçantë për të gjithë mjekët dhe personelin shëndetësor të cilët u kujdesën që çdo gjë të shkonte mirë. Krenar për rolin e çmuar të Fortlumturisë së tij dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në veçanti, për forcimin e harmonisë ndërjetare, kësaj vlere kombëtare dhe modeli unik për mbarë botën", ka thënë Meta.

Qeveria e Kosovës do të reagojë nëse vazhdon rritja e rasteve me koronavirus

Hoti: Rritja e numrit të rasteve me Covid-19 mund t'i rikthejë masat e izolimit

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka paralajmëruar se Qeveria e Kosovës mund t'i kthejë masat e izolimit total nëse vazhdon të rritet numri i infektiveve të reja me Covid-19. Ai ka bërë me dije se me këtë ritëm të infektiveve së shpejti do të bllokohet Klinika Infektive. Sipas tij, nëse ndodh kjo, mjekët do të përballen me vendime të vështira morale se kënd duhet ndihmuar më parë. Kryeministri u ka bërë thirrjeve qytetarëve që të vazhdojnë t'i respektojnë masat mbrojtëse ndaj Covid-19. Ndërsa kryetarja e Kuvendit i ka bërë thirrje qeverisë që të jetë e kujdesshme në raport me përhapjen e koronavirusit në vendin tonë



**EPOKA
ERE** Muhamet KOCI

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka vlerësuar se rastet me Covid-19 janë duke u rritur shumë. Ai ka paralajmëruar se nëse vazhdon ky ritëm, qeveria do të detyrohet t'i kthejë masat e izolimit total. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka treguar se me këtë ritëm të infektiveve së shpejti do të bllokohet Klinika Infektive, më pas mjekët do të përballen me vendime të vështira morale se kënd duhet ndihmuar më parë. "Rastet me Covid-19 po rriten shumë. Me këtë ritëm shpejt do të bllokohet Klinika Infektive dhe atëherë mjekët tanë do të përballen me vendime të vështira morale se kënd duhet ndihmuar më parë. Ato skena i kemi parë në vendet që e përjetuan shumë rëndë këtë pandemi. Nuk mund të lejojmë të na krijohen situata të tilla. Nëse vazhdon ky ritëm, do të detyrohemi t'i kthejmë masat e izolimit total, të cilat do të kenë pasojë të rënda për ekonominë dhe familjet tona", ka shkruar Hoti.

Ai i ka ftuar qytetarët e Kosovës t'i respektojnë masat ndaj

Covid-19, duke bartur maska, duke mbajtur distancën fizike dhe duke i larë duart. "Masat për t'u mbrojtur janë të thjeshta: (1) maska, (2) distanca fizike dhe (3) larja e duarve. Vetëm kaq mjafton për ta ruajtur veten, fëmijët tanë, prindërit, por edhe bashkëpunëtorët në vendin e punës, bashkudhëtarët në autobus e taksi, apo personin ngjitur në tavolinën tjetër në restorant", ka shkruar Hoti.

Ai ka deklaruar se zbatimi i manualit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe IKShPK-së është i detyrueshëm. "Ministria e Shëndetësisë dhe IKShPK-ja e kanë përgatitur manualin për masat mbrojtëse nga COVID-19, i cili është i obligueshëm. Është përgjegjësi e udhëheqësit të institucionit publik (ministri, komuna, ndërmarrje publike, agjenci etj.) dhe e pronarit të biznesit (në prodhim, restorant, shërbime, transport etj.) të sigurohen se janë marrë masat sipas këtij manuali", është shprehur Hoti, duke shtuar se mospërmbushja e këtyre masave rrezikon shëndetin e qytetarëve dhe është e dënueshme. "Nuk do të ketë tolerancë për askënd që shkel këto rregulla. Nuk mund të

pësojmë si shoqëri për shkak të papërgjegjësisë së bartësve të institucioneve apo bizneseve që nuk i ndërmarrin masat mbrojtëse adekuate", ka shkruar Hoti.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, i shoqëruar nga drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKShPK), Naser Ramadani, kanë vizituar të dielën Klinikën Infektive, për ta parë nga afër gjendjen e pacientëve me Covid-19.

Zemaj ka thënë se në këtë klinikë kishte për qëllim t'i vizitojë punëtorët shëndetësorë të cilët janë duke punuar edhe përtej orarit të caktuar. Ai ka thënë se si institucione do t'ua ofrojnë qytetarëve shërbimet më të mira të mundshme për të kaluar situatën në të cilën po kalon Kosova. I pari i shëndetësisë, teksa ka folur për shtimin e rasteve me COVID-19, ka thënë se qytetarët dhe institucionet nuk po dëgjojnë për parandalimin e kësaj pandemie. Në këtë kontekst, ai ka thënë se do të gjobiten të gjithë ata që nuk i respektojnë rekomandimet e IKShPK-së.

"Ata të cilët nuk janë duke i respektuar këto masa mbrojtëse duhet të ndëshkohen që mos ta dëmtojnë shëndetin e tjetrit apo mos ta infektojnë ndonjë person", ka thënë Zemaj. Numri i rasteve të reja të infektuarve me koronavirus ka filluar të rritet pas 1 qershorit,

kur ka filluar lehtësimi i masave ndaj Covid-19. Deri të shtunën në Kosovë numri i përgjithshëm i të infektuarve ka shkuar në 2 590, ndërsa kanë vdekur 48 pacientë. Raste aktive janë 1 148, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve tani ka arritur në 1 394.

Osmani kërkon nga qeveria të jetë e vëmendshme ndaj Covid-19

Vendimi i institucioneve të vendit për hapje të plotë ka rezultuar me rritje të madhe të personave të infektuar me Covid-19 në Kosovë. Në një tabelë të cilën e ka publikuar kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, në të cilën jepen të dhënat e infektiveve nga 12 deri më 26 qershor, Kosova renditet në vendin e tretë pas Suedisë dhe Maqedonisë për numrin e të infektuarve për 100 mijë banorë. Me këtë rast, Osmani ka thënë se shifra të tilla tregojnë se Kosova nga një storie e mposhtjes së virusit, tashmë renditet në top treshe për shtimin e rasteve të infektiveve me Covid-19. "Rritja e konsiderueshme kërkon vëmendjen urgjente të qeverisë dhe përkushtimin e të gjithëve për respektimin e udhëzimeve", ka shkruar Osmani në llogarinë e vet në "Twitter".

Arben Gashi del pozitiv me Covid-19

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka bërë me dije se ka dalë pozitiv pas testimit me koronavirus. Në profilin e vet në "Facebook", Gashi ka shkruar që se bashku me familjen e tij do të vetizolohen për dy javë. "Me simptoma të lehta, si kokëdhembje e temperaturë, dje shkova të testohem në repartin e Infektives. Unë dhe familja ime dje rezultuam pozitiv me Covid-19 dhe, për pasojë, do të jemi në izolim shtëpiak dyjavor", ka shkruar Gashi.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, NASIM HARADINAJ

GJYKATA SPECIALE VËRTETOI PRETENDIMET TONA SE ËSHTË POLITIKE

Nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj, ka vlerësuar se Gjykata Speciale ka vërtetuar se është gjykatë kryekëput politike. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka deklaruar se me publikimin e propozimaktakuzës ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit kjo gjykatë i ka konfirmuar pretendimet e OVLUÇK-së. Ai ka treguar se publikimi i propozimaktakuzës pa u konfirmuar dhe pak ditë para mbajtjes së takimit të Uashingtonit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka qenë veprim dashakeqes. Haradinaj ka ftuar spektrin politik që të bashkohet për këtë çështje. Ai ka deklaruar se OVLUÇK-ja nuk do t’i ndalë përpjekjet për ta zhbërë këtë gjykatë

pozitiv ndaj nesh. Dhe kur e pa se procesi po shkonte aty ku duhej të shkonte, për të përfituar në kohë dhe për ta shantazhuar këtë proces, e publikoi aktakuzën”, ka thënë Haradinaj, duke shtuar se është koha e fundit që spektri politik të bashkohet, duke lënë anash interesat partiake.

Nënkryetari i OVLUÇK-së ka bërë me dije se nuk kanë hequr dorë nga zhbërja e kësaj gjykate.

Haradinaj ka vlerësuar se nëse nuk arrihet të zhbëhet kjo gjykatë, atëherë duhet të shikohet mundësia që Specialja t’i hetojë edhe krimet e Serbisë në Kosovë.

“Epoka e re”: Z. Haradinaj, Gjykata Speciale ka publikuar një propozimaktakuzë ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli. Cili është qëndrimi i OVLUÇK-së për këtë çështje?

Haradinaj: OVLUÇK-ja edhe më herët ka thënë se çdo ish-ushtar i UÇK-së do të jetë cak i kësaj

gjykate. Qëndrimin për këtë gjykatë ne e kemi bërë me dije edhe më herët dhe do të vazhdojmë të deklarojmë se jo kjo gjykatë është politike. Pra, kjo është gjykatë e padrejtë sepse është një-etnike. Për mua është gjykatë raciste. Prej fillimit të punës e deri të ngritja e kësaj akuze, kjo gjykatë ka shpërfaqur atë që e kemi thënë ne, se funksionon mbi argumente politike dhe jo mbi juridike. Publikimi i kësaj akuze pak dita para se Kosova të nisë një dialog me Serbinë në ShBA, në të cilin do të bisedojë për një marrëveshje historike në mes të këtyre dy vendeve, tregon për karakterin e kësaj gjykate.

“Epoka e re”: Pra, mendoni se tani kjo gjykatë vërtetoi pretendimet e OVLUÇK-së?

Haradinaj: Natyrisht se me këtë veprim e vërtetoi argumentin tonë. Ruajtja e publikimit të kësaj aktakuze në këtë kohë dhe publikimi i emrave tregon qëllimin e saj. Këto veprime janë shkelje juridike sepse, siç e

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Nasim Haradinaj, ka thënë se publikimi i propozimaktakuzës për presidentin Hashim Thaçi dhe liderin e PDK-së, Kadri Veseli, ka treguar se Gjykata Speciale është gjykatë politike. Ai ka thënë se në këtë mënyrë kjo gjykatë ka vërtetuar pretendimet e OVLUÇK-së. Në

këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Haradinaj ka vlerësuar se ngutia e publikimit të propozimaktakuzës ka pasur qëllime dashakeqëse për Kosovën. “Natyrisht se me këtë veprim e vërtetoi argumentin tonë. Ruajtja e publikimit të kësaj aktakuze në këtë kohë, dhe publikimi i emrave tregon qëllimin e saj. Këto veprime janë shkelje juridike sepse, siç e dimë, aktakuzat publikohen vetëm pasi të konfirmohen ato nga gjyqtari i procedurës paraprake. Edhe pse të akuzohesh nuk do të thotë se je

fajtor, mirëpo publikimi i saj në këtë kohë është më tepër se puro politike dhe dashakeqëse”, ka thënë Haradinaj.

Ai ka deklaruar se publikimi i propozimaktakuzës pak ditë para mbajtjes së takimit të Uashingtonit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të konsiderohet edhe si sulm ndaj ShBA-së. “Kjo aktakuzë mund të konsiderohet edhe si sulm ndaj ShBA-së dhe shteteve të tjera që e duan Kosovën. Ne duhet ta dimë se Evropa jo çdoherë ka pasur qëndrim



e Gjykatës Speciale sepse caku i parë i shërbimeve sekrete ka qenë UÇK-ja dhe ushtarët e saj. Dhe dihet se menjëherë pas luftës filluan t'i vishen UÇK-së gjera të liga, ndërsa UÇK-ja nuk ekziston më prej vitit 1999. Pra, prej pasluftës qëllimi ka qenë që të sulmohet UÇK-ja. Mendoj se është koha e fundit që institucionet e Kosovës të tregohen unikë ndaj kësaj çështje. Në kohë të vështira ne duhet të jemi të bashkuar pa marrë parasysh bindjet tona politike. Bindjet tona politike nuk duhet të jenë arsyeje të përjasjes të cilat do ta dëmtonin shtetin. Mendoj se uniteti nuk do t'i lig partitë politike, por do t'i forcojë ato dhe do të tregohemi para botës më bindës në synimet tona.

"Epoka e re": *Mirëpo gjykata po thotë se po gjykon individët dhe jo UÇK-në?*

Haradinaj: Por ta prekësh komplet Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, t'i prekësh komandantët e zonave operative, do të thotë se e ke prekur UÇK-në. Besoj se edhe ata janë të vetëdijshëm se UÇK-ja nga individët është përbërë. Paradoksi tjetër është se ata kurrë nuk e kanë njohur luftën e UÇK-së si luftë, por si konflikt, ndërsa tani djemtë tanë duan t'i dënojnë për krime lufte.

"Epoka e re": *Unifikimi i spektrit politik, a do të thotë nisje e procedurave për zhbërjen e kësaj gjykate, siç ka paralajmëruar OVLUÇK?*

Haradinaj: Ne kemi tentuar edhe më herët ta zhbëjmë këtë gjykatë, por kemi dështuar sepse politika, edhe pse na kishte premtuar se do ta votojë zhbërjen e kësaj gjykate në Kuvend, në fund nuk e mbajti premtimin. Komplet politika na ka rrejtur. Ata që po mburren se në fillim kanë votuar kundër kësaj gjykate, nuk ishin për zhbërjen e kësaj gjykate. Ti mund të jesh kundër formimit të një diçkaje të keqe që është veprim i duhur, mirëpo nëse nuk je për heqjen e asaj të keqe, atëherë je i barabartë me atë tjetrin që e ka bërë. Ne do të provojmë. Nëse nuk mund ta zhbëjmë, ne mund ta amandamentojmë atë që t'i ndjekë të gjitha krimet. Ne nuk jemi kundër zbardhjes së krimeve të pretenduara në Kosovë. Përkundrazi, ne jemi për t'i zbuluar krimet, por jo vetëm të një etnie. Ne duam t'i zbardhin të gjitha krimet që janë bërë në Kosovë. E krimet dihet kush i ka bërë krime në Kosovë, kush ka bërë djegieje dhe dhunime dhe kush ka bërë gjenocid. Serbia është ajo që i ka bërë këto. Nëse bëhet një gjykatë për zbardhjen e krimeve në Kosovë, ne e dimë se Serbia do të dalë si shteti që ka kryer krime, ndërsa UÇK-ja do të dalë e pastër sepse ka bërë luftë të drejtë dhe luftës së drejtë ki arsyeje t'i thuash e pastër.

dimë, aktakuzat publikohen vetëm pasi të konfirmohen ato nga gjyqtari i procedurës paraprake. Edhe pse akuzohesh nuk do të thotë se je fajtor, mirëpo publikimi i saj në këtë kohë është më tepër se puro politike dhe dashakeqëse. Kjo aktakuzë mund të konsiderohet edhe si sulm ndaj ShBA-së dhe shteteve të tjera që e duan Kosovën. Ne duhet ta dimë se Evropa jo çdoherë ka pasur qëndrim pozitiv ndaj nesh. Dhe kur e pa se procesi po shkonte aty ku duhej të shkonte, për të përfutur në kohë dhe për ta shantazhuar këtë proces, e publikoi aktakuzën.

"Epoka e re": *Cila duhet të jetë përgjigja e institucioneve të Kosovës?*

Haradinaj: Kosova sot është e përcarë politikisht. Fatkeqësisht, ne asnjëherë nuk kemi mundur të flasim për një Kosovë unike. Po të ishim të bashkuar me siguri se do të çliroheshim atëherë kur janë çliuar të gjithë popujt e tjerë. Shqiptarët u mashtruan duke menduar se tani u çliuan dhe më nuk duhet të bëjmë asgjë. Menduan se me përfundimin e luftës ushtarake ka përfunduar edhe lufta politike me Serbinë. Mirëpo shërbimet sekrete, veçanërisht ato serbe që, fatkeqësisht, kanë ndërtuar rrjet ndër shqiptarë, punuan shumë në këtë drejtim dhe suksesin e arritën me formimin

Presidenti Thaçi sot në orën 20:00 paraqitet para publikut



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, sot (e hënë) do ta bëjë paraqitjen e parë publike pas propozimaktakuzës nga Zyra e Prokurorit të Gjykatës Speciale. Ai në orën 20:00 pritet të tregojë për hapat që do të ndërmarrë si president i vendit pas vendimit të Speciales. Menjëherë pas marrjes së lajmit nga Gjykata Speciale, Thaçi ka ndërprerë udhëtimin, ku ishte nisur për Uashington për të marrë pjesë në takimin e 27 qershorit, i cili pritej të mbahej në mes të Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Shtëpisë së Bardhë

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINE, 28 QERSHOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, sot (e hënë) në orën 20:00 do të paraqitet para publikut për herë të para pas propozimaktakuzës nga Gjykata Speciale. Lajmin e ka konfirmuar Presidenca e Kosovës nëpërmjet një komunikate për medie. Pas propozimaktakuzës së Zyrës së Prokurorit të Specializuar, presidenti Hashim Thaçi ka ndërprerë udhëtimin për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), ku pritej të merrte pjesë në takimin në Shtëpinë e Bardhë më 27 qershor së bashku me kryeministrin Avdullah Hoti. Thaçi të premtën e javës që shkoi ka aterruar në Aeroportin "Nëna Terezë" në Tiranë, duke njoftuar se të dielën do të bënte një adresim publik nga zyra e vet. "Sapo kam zbritur në Aeroportin 'Nëna Terezë' në Tiranë. Të dielën në mbrëmje do t'ju drejtohem me një fjalë nga zyra ime. Ju uroj një fundjavë të qetë dhe mbetem me shpresë të plotë se ditët më të mira për Kosovën dhe kombin shqiptar i kemi përpara", kishte shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Kujtojmë se propozimaktakuza për Hashim Thaçin dhe Kadri Veseli ka ndryshuar gjithçka edhe sa i përket dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas ndërprerjes së udhëtimit nga Thaçi në ShBA dhe anulimit të pjesëmarrjes në takimin e ftuar nga ShBA-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Shtëpinë e Bardhë, të njëjtën gjë e ka bërë edhe kryeministri Avdullah Hoti. Në ndërkohë nikoqiri i këtij takimi, emisari special i presidentit amerikan për dialogun, ambasadori Richard Grenell, kishte njoftuar se ky takim i paraparë në mes të përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë do të ricaktohet shumë shpejt. Ndërsa në ditën e publikimit të propozim-aktakuzës nga Gjykata Speciale ka reaguar kryetari i PDK-së, Kadri Veseli. Ai i ka quajtur politike dhe të pabazuara pretendimet e Zyrës së Prokurorit Special në kuadër të Dhomave të Specializuara. Veseli ka theksuar se publikimi i aktakuzës pa u konfirmuar është veprim i paprecedentë. Më tutje, ai ka thënë se dyshimet e ngritura janë plotësisht të pavërteta dhe nuk qëndrojnë. Gjithashtu, Veseli ka mohuar pretendimet e prokurorisë për pengim të punës së gjykatës. Ai po e par-

alajmëron popullin e Kosovës se ky proces nuk mund të jetë i besueshëm për të ndarë drejtësi të paanshme dhe të pandikuar nga rrethanat politike. "Ai po përpiqet që përmes deklaratave kundërtënëse t'i mbulojë motivet e vërteta që duket se janë politike. Dua t'i siguroj të gjithë qytetarët se nuk do të lejoj që ky prokuror dhe asnjë tjetër si ai ta njollojë në këtë mënyrë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ne kemi qenë të detyruar që ta mbrojmë veten dhe vendin tonë dhe do ta bëjmë sërish. Nëse na imponohet, edhe një herë do të demonstrojmë me fakte se UÇK-ja ka zhvilluar një luftë të ndershme për liri, kundër një prej ushtrive më të fuqishme dhe më agresore në botë, të udhëhequr nga një bandë kriminale serbesh. Luftëtarët e lirisë, që në vitet 1998 e 1999 morën armët në duar për ta mbrojtur popullin, familjet, shtëpitë dhe nderin e tyre, ndaj përpjekjeve gjenocidale të Serbisë, meritojnë vetëm nderim e lartësim dhe jo fyerje në këtë mënyrë", ka thënë Veseli. Ndaj propozimaktakuzës ndaj Thaçit dhe Veselit kanë reaguar përfaqësuesit e institucioneve dhe partive politike nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Lugina e Preshevës etj.

Ana e ndritshme e West Pointit për një kadet nga Kosova

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Ylli Dalladaku dhe Arelena Shala janë dy kadetët e parë nga Kosova që kanë diplomuar në West Point të ShBA-së. Dalladaku është rritur në qytetin e Ferizajt, Kosovë, me dy vëllezërit e tij. Babai i tij ishte një mekanik, si babai i tij para tij, dhe nëna e tij qëndroi në shtëpi për t'i rritur fëmijët. Kur ai ishte dy vjeç familja e tij u largua në Maqedoni gjatë luftës së Kosovës në 1999. Pas luftës, ata u kthyen në shtëpinë e tyre dhe Ylli kujton se luante me armë lodrash. Dalladaku gjithashtu kujton një ushtar amerikan që shërbente me NATO-n, duke i thënë të mos luante me armë dhe t'i jepte një çokollatë. Ai ndoqi një shkollë të mesme të përqendruar në shkencë dhe në vitin e tij të ri, një mentor në ekipin e xhudos rekomandoi që të konsiderojë të marrë pjesë në Akademinë Ushtarake të Kosovës. Pasi mësoi rreth West Point, ai filloi procesin e aplikimit. Ai kishte arritur në Amerikë pesë ditë para "R-



Day" dhe ishte njohur me kulturën e ShBA-së në Parkun Amusement Six Flags. Ai ka bërë punë të mirë në akademi,

duke përmirësuar çdo semestër dhe diplomë në Inxhinieri Sistemesh. Ushtarakisht ai ka mbaruar

Shkollën Ajrore dhe për Sulm Ajror dhe është zgjedhur si rreshteri i parë për Kompaninë D4. Ishte kapiteni i skuadrës

xhudo që kishte vlerësuar mentorimin që mori nga trajnerët dhe oficerët që mbështesin ekipin. Ishte në pushime pranverore në Porto Riko kur ka ndodhur pandemia Covid-19 dhe është strehuar në shtëpinë e një shoku në Florida, derisa të kthehet në West Point për t'u diplomuar. Kur të kthehet në Kosovë, ai do të shërbejë si oficer i këmbësorisë në Ushtrinë e Kosovës. Në një intervistë për "Westpointcoho", ai ka folur për fëmijërinë e tij, të qenit refugjat gjatë luftës së Kosovës dhe përvojat e tij në West Point. Ai nxjerr në pah rëndësinë e marrëdhënieve që ai formoi dhe i lidh ato me mësimet e udhëheqjes. Ai ka vërejtur se West Point është një pjesë e rëndësishme e busullës së tij morale dhe përfundon me këshilla për kadetët e ardhshëm para se të reflektojë se çfarë do të thotë West Pointi për të. "Bëni diçka të vështirë çdo ditë për ta sfiduar veten dhe të jeni në paqe kur shkoni në shtrat", ka thënë ai.

Provokojnë serbët në Gazimestan, dy prej tyre shoqërohen në polici

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Një grup serbësh kanë provokuar Policinë e Kosovës pas përfundimit të manifestimit të tyre të Vidovdanit te monumenti në Gazimestan, afër Obiliqit. Pas provokimit nga ana e serbëve, kanë ndërhyrë zyrtarët policorë, duke ndaluar dhe futur në veturë dy persona. Ndërkohë, serbët e tjerë kanë reaguuar, madje kanë tentuar të mos lejojnë largimin e veturës së policisë. Policia e Kosovës i ka thënë "Kosovapress"-it se të dielën pak para orës 14:00, gjatë manifestimit në Gazimestan, dy persona të cilët dyshohet se



ishin nën ndikim të alkoolit, kanë bërë disa provokime të

përsëritura. "Edhe përkundër vërejtjeve të dhëna nga policia,

të njëjtët kanë vazhduar provokimet dhe zyrtarët

policorë janë detyruar të ndërmarrin veprime, për t'i ndaluar provokimet dhe për t'i zhvendosur nga masa. Të njëjtët pastaj janë liruar", ka njoftuar policia. Qindra serbë kanë marrë pjesë në këtë ceremoni dhe të njëjtët nuk kanë respektuar distancën fizike dhe nuk kanë qenë të pajisur me maska e doreza. Kremtimi i Vidovdanit ndërlidhet me përvjetorin e 631-të të Betejës së Kosovës, që historia serbe e njeh si fitore shpirtërore të saj, pavarësisht një humbjeje të madhe të forcave ballkanike dhe vrasjes së princit serb Lazar.

Ndërron jetë Nikollë Mark Kërhanaj, aktivist i LDK-së

PRIZREN, 28 QERSHOR (ER) - Ka ndërruar jetë veprimtari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) nga Prizreni, Nikollë Mark Kërhanaj. Me këtë rast, kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, u ka shprehur ngushëllime familjes Kërhanaj dhe qytetarëve të Prizrenit. "Me pikëllim të thellë mora lajmin për vdekjen e shkrimtarit dhe veprimtarit të shquar, mësuesit Nikollë Mark

Kërhanaj. Nikollë Mark Kërhanaj ishte shkrimtar, historian, etnolog dhe mësues shumë i dashur. Me punën dhe angazhimin e tij gjatë dekadave të kaluara ka dhënë kontribut shumë të çmuar për historinë në Kosovë. Nikollë Kërhanaj do të kujtohet si një ndër intelektualët dhe historianët më të dashur dhe frymëzues për breza të tërë", është thënë në telegram ngushël-

limin e Mustafës. Ai ka thënë se vdekja e Kërhanajt është humbje e madhe për familjen dhe gjithë komunitetin letrar në vendin tonë. "Ndërsa veprimtaria e tij letrare dhe shkencore do të jetojnë dhe shërbejnë si udhërrëfyes i gjeneratave të tëra. Në emrin tim dhe në emër të LDK-së i shpreh ngushëllime familjes Kërhanaj, miqve, kolegëve, të gjitha strukturave të LDK-

së në Prizren dhe të gjithë qytetarëve. I lehtë i qoftë dhe i Kosovës!", është thënë në telegram ngushëllimin e kryetarit të LDK-së. Edhe kryetari i Degës së LDK-së në Prizren, Anton Quni, ka ngushëlluar familjen Nikollë Mark Kërhanajt me rastin e vdekjes së veprimtarit të kësaj partie. "Mësuesi Kërhanaj do të jetojë në kujtimet tona si njeri i urtë dhe i fjalës,



dashamirës i pendës, artist e i kulturës dhe intelektual i palodhur që organizoi me dekada manifestimin letrar për Atë Shtjefën Gjeçovin", ka thënë Quni.

Diaspora vazhdon ta paguajë sigurimin kufitar për vetura

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Qytetarët e Kosovës që jetojnë dhe punojnë në shtete të ndryshme të Evropës sa herë që hyjnë në Kosovë obligohen që në kufi të paguajnë një shumë të mjetëve financiare për sigurimin e veturave të tyre. Personat që hyjnë në Kosovë me auto-vetura duhet të paguajnë 15 euro për qëndrimin prej 15 ditësh. Ndërkaq, qëndrimi për një muaj kap vlerën e sigurimit prej 20 eurosh. Këto tarifa ndryshojnë nga kategoria e mjetëve motorike dhe periudha e qëndrimit në Kosovë.

Një nga ta është Fidaim Zeqiri, i cili që gjashtë vjet jeton në shtetin e Gjermanisë. Ai ka thënë se çmimi i policës së sigurimit nuk është shumë i lartë por vonesa, për shkak të kolonave të gjata, për të kryer këtë obligim është e

mërzitshme. “Ka pasur raste kur kam pritur më shumë se një orë derisa të vijë radha për të paguar. Ne edhe ashtu bëjmë rrugë të gjatë për të ardhur në Kosovë dhe pritja për këtë pagesë është maltretim”, ka thënë Zeqiri për “Radion Evropa e Lirë”.

Qeveria e kaluar e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, ka aprovuar një kërkesë të Ministrisë së Financave për krijimin e një mekanizmi për mbulimin e obligimeve të sigurimit kufitar nga Qeveria e Kosovës. Kjo do të vlejë për të gjithë bashkatdhetarët dhe të huajt që janë subjekt i policës kufitare dhe vijnë në Kosovë për vitin 2020.

Në anën tjetër, zyrtarë të Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga Avdullah Hoti, nuk kanë dhënë ndonjë

përgjigje se a kanë filluar procedurat për zbatimin e këtij vendimi apo do të anulohet. Hoti në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë” ditë më parë ka thënë se “qeveria do t'i analizojë me kujdes të gjitha vendimet e marra nga qeveria e kaluar për të siguruar se a janë në përputhje me ligjin”. Pagesa e sigurimit kufitar të auto-përgjegjësive është e obliguar me ligj për të gjitha mjetet motorike me tabela të huaja të cilat hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës. Aty përfshihen edhe automjetet e mërgatës, diasporës së Kosovës. Në Byronë Kosovare të Sigurimeve pohojnë se janë të gatshëm për diskutime lidhur me këtë çështje edhe pse, sipas tyre, kjo është komplekse dhe kërkon trajtim profesional.

Blerim Pushkolli, drejtor

ekzekutiv në Byronë Kosovare të Sigurimeve (BKS), ka thënë se një vendim eventual do të krijojë implikime financiare dhe duhet të shikohet edhe aspekti ligjor. Sigurimi kufitar është i bazuar në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. “Duhet të mendohet mirë për shkak të bartjes së rrezikut me lëshimin e çdo police të sigurimit. Implikimi financiar është mjaft i lartë, për shembull për një rast të siguruar që kushton 15 euro për 15 ditë, kërkesa e personave për dëmshpërblim mund të shkojë deri në 1.2 milion euro. Kurse për dëmet e shaktuara nga përdorimi i autobusit dhe mjetëve motorike të destinuara për transportin e lëndëve të rrezikshme, zbatohet dyfishi i shumave minimale të sigurimit”, ka thënë Pushkolli.

Ai ka shtuar se nëse koston e sigurimit kufitar do ta marrë përsipër Qeveria e Kosovës, atëherë do të ketë implikime financiare dhe rëndim të buxhetit të Kosovës, i cili mbulohet kryesisht nga tatimpaguesit kosovarë. “Dhe këtu është normale të shtrohet pyetja, si të ngarkohen taksapaguesit kosovarë që t'i paguajnë sigurimet e drejtuesve të mjetëve motorike me regjistrime të huaja. Por, Byroja Kosovare e Sigurimit do të jetë bashkëpunuese në proces dhe do të respektojë çdo vendim që merret nga Qeveria e Kosovës”, ka thënë Pushkolli. Nga tarifat e sigurimeve kufitare, thotë Pushkolli, vitin e kaluar janë grumbulluar mbi 7.7 milionë euro të hyra, kurse pagesa e dëmeve të paguara nga BKS për periudhën e njëjtë rezulton në 7.9 milionë euro.



Mbi 100 pacientë me Covid-19 të shtrirë në Klinikën Infektive, 4 në gjendje të rëndë

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Drejtoresha e Klinikës Infektive në Qendrën Klinike të Kosovës (QKUK), Lindita Ajazaj-Berisha, ka bërë me dije se në këtë klinikë janë të shtrirë 110 pacientë të prekur me Covid-19. Ajo ka thënë se prej tyre, gjashtë janë në mjekim intensiv dhe katër janë në gjendje kritike me frymëmarrje të asistuar. Ajo ka thënë se,

përveç Klinikës Infektive, pacientë me Covid-19 ka të shtrirë edhe në Klinikën e Pulmologjisë. “Me rritjen e numrit të rasteve ka filluar edhe rritja e numrit të tyre në Klinikën Infektive. Tanimë në këtë klinikë i kemi 110 raste të cilët janë të shtrirë, prej tyre gjashtë janë në mjekim intensiv dhe katër prej tyre janë në gjendje kritike, me frymëmarrje

të asistuar. Ky numër mund të ndryshojë pasi që kemi raste nga terreni të konfirmuar pozitiv me Covid-19. Ka rate të cilët janë shtrirë edhe në Klinikën e Pulmologjisë, prandaj do të ishte mirë që ne si qytetarë të vetëdijeshohemi, t'i respektojmë të gjitha rekomandimet e institucioneve shëndetësore”, ka thënë ajo për EO.



Prodhuesit e Kosovës heqin dorë nga tregu i Serbisë

PRISHTINE, 28 QERSHOR (ER) - Lëngjet e frutave që prodhon kompania nga Kosova "Frutomania" kanë depërtuar edhe në tregun e Afrikës së Jugut dhe në shumë shtete të tjera, duke përfshirë edhe Lindjen e Mesme. Mirëpo, në shtetin fqinj, Serbi, kjo kompani nuk ka eksportuar asnjëherë për shkak të barrierave të vazhdueshme që i ka pasur.

Pronari i kësaj kompanie, Armend Malazogu, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se kanë tentuar disa herë që të eksportojnë në Serbi, por kamionët e tyre janë kthyer mbrapshtë. "Një prej arsyeve dhe e vetmja dhe kryesorja, është që kodi i Republikës së Kosovës nuk është i regjistruar në kodin doganor të Serbisë dhe, si i tillë, Dogana e ka të pamundur që produktin e Kosovës ta zhdoganojë dhe të futet në tregun serb. Mos të flasim pastaj që certifikatat fito-sanitare të lëshuara nga institucionet e Kosovës nuk njihen nga ato serbe, kështu që na pamundëson eksportin në shtetin serb", ka thënë Malazogu.

Kodi Doganor është dokument

që përcakton rregullat doganore. Ky kod bën rregullimin e elementeve bazë të sistemit për mbrojtjen doganore të ekonomisë së Republikës së Kosovës dhe të drejtat e obligimet e të gjithë pjesëmarrësve në zbatimin e legjislacionit doganor. Problem të ngjashëm ka pasur edhe veraria "Bodrumi i Vjetër" në Rahovec.

Drejtori komercial i kësaj verarie, Fidan Haxhijaha, ka treguar për "Radion Evropa e Lirë" se "Bodrumi i Vjetër" prodhon rreth 5 milionë litra verë në vit. Ai ka thënë se tetëdhjetë për qind e këtij prodhimi eksportohet në vende të ndryshme, por jo edhe në Serbi. "Çdo eksport që shkon për Serbi, nëse është i paketuar dhe shkruan Republika e Kosovës, atëherë është i pamundur të bëhet ai eksport, se nuk e pranojnë. Për këtë arsye, ne jemi të detyruar të eksportojmë kur kemi stoqe pak më tepër, por në sistemin refuz, jo të paketuar", ka thënë Haxhijaha.

Problemet vazhdojnë edhe pas heqjes së të gjitha masave nga Kosova.

Me problemet që kanë prodhuesit kosovarë është e



njoftuar edhe Aleanca Kosovare e Biznesit. Kryetari Agim Shahini ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se barrierat që shteti i serbua vë prodhuesve kosovarë janë të trashëguara me vite. "Herë nuk e pranon certifikatën fito-sanitare, por edhe produktin që shkruan Made in Kosova. Këto janë vështirësi të vazhdueshme e në Kosovë vazhdojnë të hyjnë produktet e Serbisë pa ndonjë

problem në tregun tonë", ka thënë Shahini.

Qeveria e Kosovës ka hequr të gjitha masat që kanë qenë të vendosura për mallrat serbe në mënyrë që t'i hapet rrugë vazhdimin të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Një të tillë është kërkuar që ta bëjë edhe Serbia, që prodhuesit kosovarë të mund të eksportojnë në tregun serb. Megjithatë, bizneset e

Kosovës vazhdojnë të përballen me pengesa të ndryshme. Para vendosjes së tarifës doganore për mallrat me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, në nëntor të vitit 2018 të vendosur nga ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, Serbia ishte eksportuesja më e madhe e produkteve në Kosovë. Ky shtet brenda një viti eksportonte në Kosovë mallra në vlerë prej rreth 450 milionë eurosh.

Bizneset kërkojnë shtyrjen e pagesës së kredive edhe për tre muaj

PRISHTINE, 28 QERSHOR (ER) - Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) është e shqetësuar pas konfirmimit nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për mosshtrjen e pagesave të kësteve të kredive edhe për tre muaj të tjerë. Me këtë rast, OAK-u ka kërkuar nga BQK-ja dhe Qeveria e Kosovës që të anulohet ky vendim dhe të shtyhen kreditë dhe tatimet edhe për tre muaj si rezultat i gjendjes së rëndë në të cilën ndodhen bizneset dhe punëtorët për shkak të Covid-19. "Oda e Afarizmit të Kosovës konsideron se një vendim i tillë, e sidomos në këtë periudhë pandemike, vështirëson



operimin e mëtutjeshëm të bizneseve, meqenëse deri vonë disa kanë funksionuar me kapacitete të reduktuara e të tjerat kanë pasur të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë, gjë që ka ndikuar në zvogëlimin e

gjenerimit të të hyrave dhe stabilitetin financiar të operatorëve ekonomikë. Gjithashtu, edhe hapja e pjesërishtme që është duke ndodhur tani nuk është në nivelin e të hyrave para

pandemisë duke punuar shumica me kapacitete të kufizuara e si rrjedhojë edhe me të hyra shumë larg planifikimeve", është thënë në reagimin e OAK-ut. Sipas këtij reagimi, kërkesë e bizneseve të cilat janë duke u përballur me vështirësi financiare si pasojë e pandemisë është që shtyrja e kredive dhe tatimeve të bëhet edhe për tre muaj të tjerë, duke u mbuluar pjesa e interesit nga ana e shtetit. "OAK-u rikujton që efektet e pandemisë në masë të madhe pritet të vihen re pas tejkalimit të saj. Si rezultat i kësaj duhet të ofrohen mekanizma për përkrahjen më të madhe të

komunitetit të biznesit, në mënyrë që të kenë mundësi për rimëkëmbje, ruajtje të stabilitetit dhe funksionim të rregullt të ekonomisë. OAK-u kërkon nga Qeveria e Kosovës, Banka Qendrore dhe partitë politike që të punojnë shumë më shumë në përkrahje të bizneseve dhe qytetarëve dhe krijimin e një oferte më të mirë të të bërit biznes në mënyrë që të mund të ruhen vendet aktuale të punës dhe të ketë mundësi të rritjes së punësimit. Për rikujtim janë rreth 30 aplikime për investime strategjike që janë duke pritur me vite aprovimin e tyre", është thënë në reagimin e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK).

MF-ja po e shqyrton mënyrën e tërheqjes dhe kompensimit të 10-përqindëshit të mjeteve nga Trusti

PRISHTINE, 28 QERSHOR (ER) - Ministria e Financave (MF) është duke shqyrtuar propozimin për tërheqjen deri në 10 për qind të kursimeve në Trustin Pensional nga qytetarët si ndihmesë në kohën e pandemisë. Nga kjo ministri kanë thënë se janë duke shqyrtuar mundësinë për kompensimin e mjeteve financiare.

Zëvendësministri i Financave, Agim Krasniqi, në një intervistë për "Ekonomia Online" ka thënë

se pasqyra e Trustit të qytetarëve është në diferencë të madhe. Andaj, siç ka deklaruar ai, kjo ministri është duke shikuar mundësinë për t'i kompensuar të gjithë qytetarët njësoj. Krasniqi ka potencuar se një pjesë e madhe e qytetarëve kanë kursime të vogla. "Kjo çështje është si ide, qëllimi primar ka qenë që të mobilizohen më shumë fonde për ta rritur kërkesën agregate dhe ofertën. Se a do të ketë kompensim jemi duke e shqyrtuar këtë çështje se



si ka me qenë. Pasi ne duhet të jemi të kujdesshëm pasi nëse shohim tabelat e trustit të qytetarëve, një pjesë e madhe ka kursime shumë të vogla. Një

pjesë e madhe do të përfitonin shumë pak. Në anën tjetër një pjesë tjetër do të përfitonte shumë. Nëse këtë kompensim e bëjmë barabartë. Varësisht prej tërheqjes nuk është në rregull. Është duke u diskutuar për ta gjetur modalitetin nga i cili ndahen të kënaqur të gjithë", është shprehur Krasniqi.

Më tutje, zëvendësministri Krasniqi ka bërë dallimet ndërmjet personave që ka thënë se kanë 10 mijë euro e shumica prej tyre vetëm 100 euro. Në këtë

kontekst, ai ka thënë kjo është në shpërputhje me paratë publike. "Te çështja e kompensimit mendoj se nuk duhet të kompensohet ajo që tërhiqet. Nëse dikush e ka mundësinë që 10 mijë euro t'i tërheqë e t'ia mundësojë shtetit t'ia kompensojë, kurse tjetri që i ka 100 euro, vetëm 100 euro nuk është në rregull në kuptimin e parasë publike. Kontributet janë të të gjithëve, por në pjesën e kompensimit duhet të kemi kujdes", ka thënë Krasniqi.

OEAK-u: Lufta e brendshme politike po rrezikon ndërmarrjet dhe vendet e punës në Kosovë

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEK) u ka bërë thirrje aktorëve politikë në Kosovë që të ndërmarrin hapa konkretë për rimëkëmbjen ekonomike dhe ta ndalin luftën e brendshme politike. Kjo odë ka theksuar se në situatën aktuale nëpër të cilën po kalon sektori privat në veçanti dhe ekonomia e vendit në përgjithësi është e nevojshme që temat e natyrës politike dhe mospajtimet rreth tyre të mos i mbidominonjë temat që lidhen me përkrahjen e sektorit privat dhe rikuperimin e ekonomisë pas pandemisë Covid-19.



do t'i shpërfaqin pasojat reale të pandemisë Covid-19 në ekonominë e vendit, që do të rezultojnë me kolaps masiv të ndërmarrjeve, rritje të papunësisë dhe varfërisë, zvogëlim të të hyrave buxhetore dhe reduktim të aftësisë së shtetit për të ofruar shërbime publike dhe investime kapitale", është thënë në këtë njoftim, duke shtuar se gjatë këtyre muajve institucionet duhet të fokusohen te çështjet ekonomike. "Përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2020 Qeveria e Kosovës do të duhej të angazhohej me seriozitet të pashembullt për përbushjen e agjendës legislative për këtë vit, ndërsa nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës pritet që ta përqendrojnë debatin parlamentar në aspektet ekonomike në vend të mospajtimeve të ngushta politike e debateve për tema të panevojshme të cilat pengojnë reformën e progresin, rritjen e shpejtë ekonomike dhe ngritjen e mirëqenies sociale. Krejt në fund, Oda Ekonomike Amerikane thekson edhe nevojën e rritjes së dinamizmit të Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik, ku sektori privat duhet t'i ofrohet hapësira për ta luajtur rolin parësor në zhvillimin e programit të rimëkëmbjes, reformimit e mjedisit për të bërë biznes dhe fuqizimin e sektorit privat", ka njoftuar OEAK-u.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Masat për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19 kanë kufizuar në masë të madhe aktivitetet ekonomike, që sjellë pasojat me kosto të lartë të rikuperimit për një ekonomi me strukturë të paqëndrueshme si ajo e Kosovës për shkak të kërcënimit afatgjatë për ndërmarrjet, vendet e punës dhe stabilitetin buxhetor. Kështu ka vlerësuar Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës (OEK). Kjo odë ka vënë me dije se në rrethana të tilla veprimi i shpejtë dhe konsensual nacional është i domosdoshëm për ta ruajtur ekonominë vendore. Në këtë kontekst, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka kërkuar nga të gjitha institucionet, Qeveria dhe Kuvendi, por edhe partitë

politike që ta shmangin luftën e brendshme politike dhe të ndjekin një agjendë dinamike të veprimeve që do ta mundësonin ndërhyrjen e shpejtë të shtetit për ndërmarrjet dhe punonjësit e rrezikuar. "Oda Amerikane beson fuqishëm se në situatën aktuale nëpër të cilën po kalon sektori privat në veçanti dhe ekonomia e vendit në përgjithësi është më se e nevojshme që temat e natyrës politike dhe mospajtimet rreth tyre të mos mbidominonjë temat që lidhen me përkrahjen e sektorit privat dhe rikuperimin e ekonomisë pas pandemisë Covid-19. Moszbatimi deri në fund i masave të Pakos Emergjente Fiskale dhe vonesa për aprovimin e një programi të rimëkëmbjes, edhe për shkak të vonesës së aprovimit nga ana e Kuvendit të Kosovës të rishikimit buxhetor dhe marrëveshjeve të kredive

ndërkombëtare, të cilat janë kyçe për zbatimin e masave të ndërhyrjes shtetërore, përbëjnë kërcënim serioz për dhjetëra mijëra vende të punës. Këto vonesa janë edhe rrjedhojë e dështimit të koordinimit dhe pajtimit të brendshëm institucional dhe politik, por edhe të dialogut të mangët dhe jo të sinqertë publiko-privat përgjatë katër muajve të fundit. Kjo do të bëjë pashmangshëm që Kosova ta humbasë hapin në rimëkëmbjen ekonomike dhe në ofrimin e një perspektive më premtuese për qytetarët e saj", ka njoftuar OEAK-u.

Derisa të gjitha deklaratat e OEAK-ut dhe të organizatave të tjera që përfaqësojnë interesat e sektorit privat në vend kanë folur për kufizime dramatike të aktivitetit ekonomik, e të konfirmuara edhe nga të dhënat e autoriteteve

tatimore e doganore, të njëjtat shqetësime duket se nuk kanë alarmuar vendimmarrësit shtetërorë dhe partitë politike, të cilët, fatkeqësisht, u kanë dhënë prioritet çështjeve politike duke zgjedhur t'i theksojnë mospajtimet e tyre. "Oda Amerikane ua rikujton udhëheqësve politikë të Kosovës se zhvillimi ekonomik kërkon një qasje të unifikuar nacionale ndërmjet të gjithëve hisedarëve politikë dhe jopolitikë, e cila do të kulmonte me një strategji nacionale të zhvillimit ekonomik dhe do ta garantonte konsistencën në qeverisjen ekonomike në vitet në vijim. Diskursi thellësisht përçarës politik i muajve të fundit, fatkeqësisht nuk u kontribuon synimeve të sipërcekura. Në rast të vonesës së mëtejme të përkrahjes për sektorin privat, muajt në vijim

Kosova rrezikon t'i humbasë fondet ndërkombëtare, paralajmërohet ulja e pagave në sektorin publik

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Kosova rrezikon t'i humbë rreth 300 milionë euro nga marrëveshjet financiare ndërkombëtare nëse vazhdohet kështu të kundërshtohet ratifikimi në Kuvend. Ministria e Financave ka paralajmëruar uljen e pagave në sektorin publik, përfshirë këtu edhe pagat e deputetëve që aktualisht i kanë mbi 2 000 euro. Zëvendësministri i Financave, Agim Krasniqi, në një intervistë



për "KosovaPress", ka thënë se në rast se këto marrëveshje financiare nuk kalojnë, duhet rishikuar ose rikthyer rishikimin e buxhetit, që

nënkupton zvogëlimin e shpenzimeve ose zvogëlimin e pakos për rimëkëmbje ekonomike. Krasniqi ka thënë se pa u votuar rishikimi i buxhetit 2020 nuk do të zbatohet as pakjoja për rimëkëmbje ekonomike e as pakjoja emergjente fiskale. "Pjesë e rishikimit është edhe pakjoja shtesë prej 620 milionë eurosh. Në rast se këto marrëveshje nuk kalojnë,

atëherë duhet rishikuar ose rikthyer rishikimin e buxhetit, që nënkupton zvogëlimin e shpenzimeve. Këto shpenzime ose duhet t'i zvogëlojmë shpenzimet e rregullta ose duhet ta zvogëlojmë pjesën që ka të bëjë me pakon për rimëkëmbjen ekonomike. Të dyja janë të dhimbshme", ka thënë Krasniqi. Ai ka thënë se disa prej pesë marrëveshjeve financiare

ndërkombëtare që janë duke pritur për ratifikim që prej shumë kohësh rrezikohen të humbin fondet dhe të pësojë ekonomia e Kosovës. Sa i përket zbatimit të pakos emergjente ose masës 3A dhe masës për mbështetje për bizneset, Krasniqi ka thënë se nuk do të ekzekutohen këto paga pa u rishikuar buxheti në Kuvend pasi, sipas tij, nuk ka asnjë mundësi ligjore.

Rihapet aeroporti "Adem Jashari", Zemaj u uron bashkatdhetarëve mirëseardhje

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) "Adem Jashari", të shtunën pas mesnatës ka aterruar aeroplani i parë nga Baseli pas më shumë se tre muajsh ndërprerje. Të gjitha fluturimet ishin të pezulluara si pasojë e përhapjes së pandemisë Covid-19. Këtë fluturim i është gëzuar menaxhmenti i këtij aeroporti. "Është kënaqësi ta mirëpresim fluturimin e parë nga

Baseli me 'Air Mediteranean', fluturim ky që solli udhëtarët e parë më 28. 06. 2020 në orën 00:50 pas më shumë se tre muaj në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari' LKIA", ka njoftuar ANP-ja. Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, u ka uruar mirëseardhje të gjithë bashkatdhetarëve. Zemaj ka thënë se tashmë e kanë hapur Aeroportin Ndërkombëtar

"Adem Jashari" dhe se Kosova është bërë gati për ta pritur mërgatën. "Gjatë muajve të verës ju jeni energjia e atdheut. Ju i jepni shpirt dhe e gjallëroni vendin. Paratë e djersës, remitanat që dërgoni, janë frymëmarrja dhe vullti i ekonomisë së Kosovës. Atje ku jetoni jeni krenaria jonë. Ju çdo ditë e ndieni mungesën e vendlindjes, zemrën e mendjen e keni në Kosovë, sikurse dhe ne

tek ju", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook". Zemaj ka theksuar se muajt e fundit pandemia Covid-19 ka shkaktuar mbylljen e kufijve dhe brutalisht ka bërë të jetë kjo ndarje. "Që nga dita e parë ne si qeveri kemi vënë në lëvizje tërë potencialin e ministrisë që të mundësohej sa më parë hapja e aeroportit 'Adem Jashari'. Sapo të zbrisni nga aeroplani në tokën e Kosovës mos u bezdisni nëse



mjekët tanë do t'jua bëjnë matjen e temperaturës trupore ose ndonjë kontroll mjekësor. Këtë e bëjnë për ta parandaluar përhapjen e virusit", ka shkruar Zemaj.

Mos na e çani bythën se nuk po gjykohet Ushtria Çlirimtare e Kosovës!



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Ushtri e lavdishme në një mjedis të palavdishëm: Rezistenca dhe qëndresa e shqiptarëve asnjëherë nuk u ndërpre që nga aneksimi apo pushtimi klasik që e bëri Serbia dhe që e mbajti nën okupim duke përdorur dhunë dhe terror të pashembullt deri në gjenocid gjatë luftës së lavdishme të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Tokat shqiptare menjëherë pasi Serbia u bë e pavarur nga Turqia, nën dhunë të paparë u zbrazen duke krijuar kolona dhjetramijëshe dhe qindramijëshe të "muhaxhirëve" që dhunshëm u shpërngulen në Kosovë. Fuqitë e mëdha të asaj kohe nuk reaguese sepse në orbitën e interesave globale shqiptarët, të përçarë dhe pa identitet shtetëror nuk ishin askund, kurse Perandoria Otomane edhe në grahmat e fundit të shpërbërjes dhe shuarjes së saj, çdo kryengritje shqiptare e shtypte me gjak. Ishte fati historik dhe bekim i Zotit që në vitin 1912 në Vlorë, në një territor jo më të madh se një lagje e vogël e Prishtinës, Ismail Qemali, të cilin e ndoqën nga Durrësi ku kishte planifikuar ta shpallte pavarësinë e Shqipërisë, në atë territor miniatural, i përkrahur dhe mbrojtur nga trimat e Kosovës, e shpalli Pavarësinë e Shqipërisë si shtet, atdhe dhe mëmëdhe i të gjithë shqiptarëve. Po të mos shpallej në atë kohë kjo pavarësi, çështja shqiptare do të zhdukej si Perandoria e Majave dhe Inkave. Edhe atëherë bashkësia ndërkombëtare, kryesisht ishte në përkrahje të Serbisë (mbretërisë) dhe kundër shqiptarëve. Luftën për liri dhe identitet shtetëror shqiptarët e paguan me çmim shumë të lartë duke i marrë territore çdo shteti që kufizohej me hapësirat ku jetonin shqiptarët. Mali i Zi i mori Ulqinin, Hotin dhe Grudën, Plavën dhe Gucinë sikur që deshi ta merrte edhe Shkodrën. Grekët i aneksuan Artën, Nartën dhe e zbrazen Çamërinë nën krimet e gjeneralit Metaksa që mbeti i pandëshkuar, kurse pronat e shqiptarëve ua kaluan grekëve dhe shtetit të andartëve grekë. Ahmet Zogu, një mbret pa prejardhje dhe një analfabet i dhunshëm dhe mizor, përkundër kundërshtimit të Kuvendit të Shqipërisë, si vartës i Nikolla Pashiqit ia fali pjesën më të bukur të Ohrit, së bashku me Shën Naumit, Manastirin mbretërisë së atëhershme serbo-sllaveno-

kroate e që tash padrejtësisht i takon shtetit maqedonas. Fuqitë e mëdha të asaj kohe territoret shqiptare i përdornin si monedhë për kompensim shteteve që kishin fituar luftërat ballkanike dhe Luftën e Parë Botërore. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria u tradhtua nga Jugosllavia duke e riokupuar Kosovën dhe trojet e tjera shqiptare përkundër faktit se forcat nacionaliste, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, asnjëherë nuk e ndalën qëndresën duke e kundërshtuar regjimin komunist deri në sakrificë sublime. Menjëherë pas përfundimit të luftës, toka e Kosovës u njom me gjakun e nacionalistëve shqiptarë sikur që Kosova u shndërrua në një varrezë masive e mbushur me nacionalistë shqiptarë sikur që, që nga viti 1945 e deri në vitin 1998, burgjet jugosllave dhe serbe ishin të mbushura kryesisht me të burgosur politikë shqiptarë. Këndej na vrisnin dhe arrestoni serbët, së bashku me shqiptarët e serbizuar politikisht dhe mendërisht, kurse në Shqipëri këtë e bënin komunistët analfabetë të regjimit enverist, gjithashtu analfabetë të Shqipërisë që u formua nga Jugosllavia dhe u përkrah nga Jugosllavia, Bashkimi Sovjetik, Kina, Vietnamit dhe shtetet e paktit të Varshavës që ishin sinonim i shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe luftës për liri. Realisht, partizanët e Shqipërisë, së bashku me çetnikët jugosllavë (me uniformë të partizanëve) e shtypën me dhunë dhe terror kryengritjen e Drenicës që udhëhiqej nga Shaban Polluzha, Mehmet Gradica dhe patriotët e tjerë sakrifikuës shqiptarë. Askush nuk u përgjigj kurrë për këto krime e as për ndjekjet e çdo patrioti shqiptar pas përfundimit të luftës. Thuaia 8-10 000 shqiptarë u masakruan në Masakrën e Tivarit dhe askush nuk dha asnjëherë përgjegjësi për këto krime. Udhëheqësit komunistë në Shqipëri kishin informata për këto krime, por e bënin punën e strucit, kokën e fusnin në rërë kinse për të mos parë asgjë, kurse prapancën ua kishin shitur jugosllavëve, rusëve, kinezëve dhe të tjerëve. Në atë kohë shqiptarët e Kosovës arrestoheshin, torturoheshin, dënoheshin dhe pushkatoheshin nga alishukritë, sinanhasanët, fadilhoxhët, gungët, kolëshirokët, sylejmanët, mehmetmalikët që ishin 100 për qind në shërbim të Jugosllavisë dhe 100 për qind kundër shqiptarëve liridashës. Pasardhësit biologjikë të tyre edhe sot e bëjnë të njëjtën punë, me përjashtime të vogla.

Baca Adem Demaçi, feniksi dhe marathonomaku shqiptar në luftë për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar: Zjarri liridashës asnjëherë nuk u shua

në trojet e okupuara shqiptare. Patriotët shqiptarë trupat e tyre i përdornin si drunj për ruajtjen e këtij zjarri, kurse djersën dhe gjakun e tyre e përdornin si vajguri. Ishin Azem Bejta e Shotë Galica, Shaban Polluzha e Mehmet Gradica, Gjon Serreçi e Marie Shllaku, Rifat Berisha dhe Ukshin Kovaçica, Mulla Idriz Gjilani dhe Shyt Mareci, Shaban Shala dhe Fazli Grajçeci, Tahir dhe Nebih Meha, Adem, Hamëz dhe Shaban Jashari, Remzi Ademaj dhe Ilaz Kodra, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Mehë Uka, Fahri dhe Bhri Fazliu, Agron Rrahmani dhe Besnik Rastelica. Ishte Mujë Krasniqi, Mici dhe komandant Toni, ishin Elton Zherka dhe Permet Vula, ishte Ali Ajeti dhe Agim Ramadani, Bedri Shala dhe Bekim Berisha, Sali Çeku dhe Abedin Rexha, Shkëlzen dhe Luan Haradinaj. Ishin mbi 2500 heronj të rënë në altarën e lirisë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 12 000 civilë të paarmatosur shqiptarë të masakruar nga forcat policore, paramilitare dhe ushtarake serbe, me dhjetëra mijëra femra të dhunuara shqiptare, qindra mijëra të shpërngulur shqiptarë dhunshëm nga trojet e veta. Ishin me mijëra të burgosur politikë shqiptarë që e lanë lirinë dhe jetën në llogoret e Jugosllavisë dhe Serbisë që e vendosën një gur të madh në themelet e qëndresës në luftën për liri dhe bashkim kombëtar. Ishin me qindra ushtarë të mobilizuar dhunshëm në ushtrinë jugosllave që u ekzekutuan mizorisht nga kriminelët serbë dhe ata që flisnin shqip. Ishin masakrat e Mejës, Krushës së Madhe dhe të Vogël, të Pataselës, të Izbices, të Rezallës, të Reçakut, të Therandës, të Dardanisë, Çyshkut, Besianës, Vushtrisë, Mitrovicës dhe ishin masakrat në të gjitha vendet e Kosovës që e sollën një liri të pjesshme dhe një çlirim të paçliruar. Ishin brezat e tërë të edukuar politikisht dhe kombëtarisht nga feniksi dhe marathonomaku shqiptar për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar, i pavdekshmi dhe i përjetshmi Baca Adem Demaçi që asnjëherë nuk e ndalën luftën dhe rezistencën drejt cakut përfundimtar, liria dhe bashkimi kombëtar. Ishin ushtarët e komandantit legjendar, të pavdekshmit Adem Jashari që e kaluan rubikonin e frikës, e rikthyen krenarinë dhe dinjitetin kombëtar duke u përballur me njërën ndër ushtritë më të fuqishme, më të tmerrshme dhe më kriminale në Evropë, ushtrinë jugosllave dhe serbe. Këta ishin themeluesit, oficerët, ushtarët dhe krahu politik i ushtrisë së sakrifikuës të kohëve të reja, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këta, të ndihmuar nga aleatët, e sollën lirinë, edhe për ata që e

merituan sikur edhe për ata që nuk e merituan dhe po e shpërdorin sikur dikur baballarët dhe majkat e tyre në regjimin jugosllav dhe serb.

Periudha e pasluftës: Sot ka analistë dhe protagonistë që meritat për këtë gjysmëliri ia mveshin vetes dhe atyre që nuk bënë asgjë për këtë vend, madje punuan dhe ende punojnë kundër këtij vendi. Pas më shumë se 20 vjetëve trillojnë për Rambujenë dhe e kritikojnë të pavdekshmin Adem Demaçi pse, edhe pas refuzimit, nuk shkoi atje. Baca Adem gjatë takimit kualifikues me Robin Kukun në Shkup i tregoi arsyet pse, në asnjë rrethanë dhe me asnjë kusht nuk do të shkonte në Rambuje, ishin pikat e panegociueshme dhe e para se: "Garantohet integriteti territorial dhe sovraniteti i Jugosllavisë mbi Kosovën që ia mbylli të gjitha dyert e kështjellës së Rambujesë, Bacës...". Dhe Baca bëri mirë që nuk shkoi në Rambuje, ndryshe nuk do të ishte Adem Demaçi. Pavarësia e kushtëzuar e Kosovës nuk ishte rezultat i nënshkrimit të marrëveshjes nga pala e Kosovës, por ishte rezultat i refuzimit të nënshkrimit nga pala serbe. Paradoksalisht, në delegacionin e Kosovës në Rambuje kishte të tillë që do të pranonin çdo gjë dhe nuk do të sakrifikonin asgjë dhe që, me dhi dhe me thi i kishin shërbyer Jugosllavisë dhe Serbisë. Ndërkombëtarët që nga Rambujeja filluan ta trajtojnë palën e Kosovës si palë shërbyese, kurse palën serbe si palë partnere.

Udhëheqësit e Serbisë, më shumë apo kryesisht janë ndjekur për krime luftime në Bosnje dhe Kroaci dhe simbolikisht për krime luftime në Kosovë. Në Kosovë, pas përfundimit të luftës, që nga rasti Trajkoviçiq e deri te rasti i fundit kur një serb nga Krusha e Madhe u dënua për krime luftime, gjithmonë ndërkombëtarët kanë pasur qëndrim paternalist ndaj të dyshuarve serbë për krime luftime, ndërsa kanë qenë të pamëshirshëm në ndjekjen e shqiptarëve, më pak nga ish-Tribunali i Hagës e shumë më shumë nga gjykatat e kriminalizuara të UNMIK-ut dhe EULESH-it që, sipas dëshmimeve të vet personelit të këtyre misionëve, maksimalisht e kanë materializuar, përmes sekserëve mendermethënë avokatë kosovarë, kurdisjen e fajësisë e sidomos shitjen e pafajësisë. Ndërkombëtarët gjithmonë kanë deklaruar se me këto arrestime të shumta dhe pa asnjë kriter, nuk po gjykohet UÇK-ja, por vetëm disa individë. Nëse që nga përfundimi i luftës nuk ka mbetur oficerë, komandantë dhe shumë ushtarë të UÇK-së, pa u arrestuar, pa u marrë në pyetje,

pa bërë përpjekje të blihen dëshmi të rrejshme, si nga krahu politik ashtu edhe nga ai ushtarak, si mund të flitet se nuk po gjykohet UÇK-ja. Mos po mendojnë se jemi krejt të marrë dhe se të gjithë ne duhet të mendojmë dhe veprojmë si pasardhësit biologjikë dhe politikë të rrahmanmorinëve, alishukrive, mehmetmalikëve, fadilhoxhëve, sinanhasanëve, gungaçëve, sylejmanëve apo kolëshirokëve?!

Ndërkombëtarët sikur janë penduar që e bombarduan Serbinë, tash po ia kthejnë fitimet me kamata të larta të cilat po i paguajnë ata që në çfarëdo forme kanë kundërshtuar robërinë apo që kanë bërë edhe sakrificë sublime. Pas amnestimit të të gjitha krimeve të Serbisë në Kosovë, në me krye pinjollin e Vojvodës Sheshel, kriminelin e luftës Aleksandër Vuçiqin, pas 21 vjetëve po bëjnë përpjekje ta rishkruajnë historinë duke i ndërruar rolet; Serbia qenka viktimë, kurse Kosova qenka kriminale, Aleksandër Vuçiq, "Legjia" dhe gjeneral Dikoviç janë paqebërës dhe paqeruajtës, kurse Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Ramush Haradinaj qenkan kriminelë luftime dhe rrezikues të paqes. Për Serbinë kurrë nuk u formua asnjëherë një Gjykatë Speciale ndonëse ishte planifikuese, përgjegjëse dhe zbatuese e të gjitha krimeve në hapësirat e ish-Jugosllavisë, kurse për Kosovën, 20 vjet pas përfundimit të luftës, në rrethana të një terrori të paparë, Kuvendi i Kosovës u detyrua ta votojë themelimin e një Gjykate Speciale që do të dënojë vetëm shqiptarë. Realisht pati të tillë që, me shkrime dhe angazhime konkrete, si pasardhës të atyre që i përmenda më lart, ndihmuar themelimin e kësaj gjykate. Gjaku nuk bëhet ujë!

Bërja publike, krejtësisht kundërligjshëm pikërisht nga ndërkombëtarët e që u përkrah nga ndërkombëtarët me orientim politik biseksual si puna e Karla Bildit, Petriçit (mund të jetë edhe Petroviçiq), që kur grazhdi i Kosovës kishte shumë para klithnin pak edhe për Kosovën, kurse tani kur grazhdi i Serbisë është fort i mbushur, fuqishëm brohorasin për Serbinë, qartazi e vërteton injorancën tonë që qorrazi u kemi besuar këtyre korbave shëtitës që jetojnë dhe mbijetojnë në kurriz të viktimizeve dhe e kemi nënçmuar Serbinë si kolektor dhe ndotës të mjedisit në këto hapësira. Për këta të vendit nuk është ndonjë befasi, ata e bëjnë punën që ua kanë transmetuar në ADN-në e tyre paraardhësit biologjikë.

Që nga përfundimi i luftës nuk mund ta gjeni asnjë personalitet, goftë ushtarak apo politik të

UÇK-së që nuk është ngrehur zvarrë nga hetuesit e ish-Tribunalit të Hagës, gjykatave të UNMIK-ut dhe EULESH-it për të vazhduar tash nga mbetjet e këtyre gjykatave e që janë sistemuar në Gjykatën Speciale. Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli janë vetëm pjata e parë që do të përdoren nga të pangopurit ndërkombëtarë që në emër të drejtësisë po e instalojnë krimin ndaj 12 000 të vrarëve në Kosovë duke i lënë këto viktime pa mundësi të arrijnë drejtësinë. Në këtë pjatë, apo siç është e shkruar, “të tjerët” pa asnjë dyshim janë personalitetet ushtarake dhe politike të ish-UÇK-së, ndërsa që në menynë e këtyre prokurorëve pa asnjë dyshim do të jenë edhe shumë ushtarë dhe komandantë të tjerë të UÇK-së. Ka mbetur që t’i nxjerrin nga varri edhe Adem Demaçin, Adem Jasharin dhe të gjithë heronjtë e vrarë për ta kompletuar skemën e krimit të imagjinuar në përpjekje ta ndërrojnë historinë dhe t’i ndryshojnë rolet. Prandaj, nëse ju ka mbetur vetëm pak njerëzillëk, mos na çani bythën e të bëni përpjekje të na bindni se nuk po e gjykoni UÇK-në. Askush nuk ju beson, kurse ata që po ju përkrahin, e kanë gjykuar UÇK-në edhe para juve. Historinë e bëjnë ata që japin të tërën për lirinë e popullit që i takojnë, pa shkelur të drejtat e të tjerëve, historinë e shkruajnë ata që duan të përfitojnë materialisht dhe ta spastrojnë të kaluarën, kurse historinë e tillë e “lexojnë” ata që para vetes i mbajnë këta libra, kurse në kokë e kanë një histori të cilën e kanë mësuar përmendësh qoftë nga të parët e tyre, qoftë nga ata të cilëve iu kanë shërbyer dhe u shërbejnë sot e kësaj dite. Dëshët apo nuk dëshët ta pranoni, historinë e re të Kosovës e bëjnë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Ramush Haradinaj dhe “të tjerët” dhe të gjithë ata që u sakrifikuara për këtë vend. Ndërsa në faqen e parë të kësaj historie janë figurat e pavdekshme: udhëheqësi shpirtëror dhe politik për liri dhe bashkim kombëtar, Baca Adem Demaçi dhe udhëheqësi ushtarak, komandanti legjendar Adem Jashari. Mos u ngutni e të gëzoheni para kohe se asgjë nuk ka mbaruar. Jemi pikërisht në fillim të procesit dhe të ngjarjeve. Nuk ka bisedime për Kosovën dhe shqiptarët dhe asnjë marrëveshje pa ata që luftuan dhe u sakrifikuara. Edhe nga burgu janë më të fortë se këta që zgërdhohen duke menduar se u rikthye koha e tyre. Në këto rrethana nuk ka bisedime dhe nuk do të duhej të ketë bisedime. Nuk ka tjetër histori përveç asaj të vuajtjeve, varreve, sakrificës dhe heroizmit. Këta që e bëjnë historinë i kanë të gjitha këto, ndërsa këta që po gëzohen dhe duan ta rishkruajnë historinë (me alfabetin cirilik), janë e kundërta e tyre. Të fundosur, të pareciklueshëm, të pafytyrë dhe të mbuluar me turp!



Denion NDRENIKA

Ibrahim Rugova pati thënë një shprehje që po e përmend me përafërsi, pa dashur ta ndryshoj thelbin dhe qëllimin, që shqiptarët kanë bërë kompromis duke mos u bashkuar Kosova me Shqipërinë, me pritshmëri të Kosovës së pavarur. Pavarësisht prej dallimeve të rrjedhura nga pushtimi genocidal serb i viseve të Shqipërisë që mbetën dhunshëm jashtë shtetit që nisi formësimin në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe u vendos në Kuvendin e Vlorës, populli shqiptar dhe pjesët e tij të ndara mbeten një dhe të pandryshuar në qëllimin e këtyre dy akteve madhore të kombit të shprehur në vullnetplotni, pra shtetin e vetëm tonin. Rrjedhat e historisë na shtynë të ecim ndarazi pa dëshirë dhe absolutisht shpirtërisht të bashkuar. Mirëpo, dhunimi i çlirimit të Shqipërisë Verilindore, pra Kosovës, me akuza të ulëta të kohëpaskohshme dhe askund të vërtetuara sado qoftë pjesërisht, natyrisht që duhet ta ndryshojnë heshtjen dhe kokuljen tonë në emër të qetësisë dhe paqes, ndonëse e kemi bërë kurdoherë edhe me vendimet e pandalshme kundër shqiptarëve në Shën Stefan, Berlin, Londër, Versajë,

Heshtja dhe kokulja nuk kanë më kuptim, kujtesë me kast në Ditën e Çamërisë

Lozanë, Firenze, Jaltë, Potsdam e deri te Rambujeja, Kai Aide dhe Marti Ahtisari. Nuk kam ndërmend ta justifikoj sjelljen e udhëheqësive tona politike, veçanërisht poshtëruese të Shqipërisë që kur pranoi ta dorëzojë në Lidhjen e Kombeve kufijtë shkatërrues të Londrës. Por, kam ndërmend të shkruaj të vetmin qëndrim të pandërrueshëm që kam, për çështje të re sot e të vjetër ndër vite, të përlules dhe heshtjes tonë tash kur Gjykata Speciale thirri Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin. As që më intereson, se cilët janë këta personazhe, andaj nuk ua vendosa titullimet përbri emrave, por më intereson pozita që kanë mbajtur në luftën për çlirimin e viseve të Shqipërisë me betimin e Ushtrisë tonë të Kosovës për bashkim. Natyrisht që njëra rrugë, ajo e presidentit Rugova, ishte ajo që ai vetë e tha për kompromisin. Rruga e ecur ishte e ndarjes me shtet të ri të trojeve të Shqipërisë ani pse kurrkush nuk ka hedhur poshtë me vullnet të plotë dhe të lidhjen Shqiptare të 1878 dhe pavarësinë e 1912-s, pra që ta justifikojnë këtë rrugë të re. Megjithatë ne shqiptarët pranuar. Mirëpo, rruga deri më tash se me dy shtete qetësojmë dynjanë zhurmëkotë për sajësën e pavend në jetë të jetëve për një Shqipëri të Madhe, me akuzat e Gjykatës Speciale po dëshmohej se është thuarje e gabuar. Në fakt, jo veç me këto, por me tërë sjelljen kryekëput evropiane dhe sllavofrikanake përballë

Rusisë, ka dëshmuar se kompromisi ynë, heshtja dhe kokulja jonë, nuk kanë shërbyer. Jo vetëm nuk na kanë respektuar, por na vijojnë përbuzjen. Pa shihni, kujtoni mirë se Evropa ua ka hapur dyert sllavëve, serbëve, malazezëve dhe maqedonasve, kur të parët kategorikisht nuk pranojnë se përjetë masakrojnë fqinjët dhe asnjë bashkëpunim për Krimet e Luftës, të katër luftërave që ndezën në Ballkan në vitet '90, gjë e kanë bërë pareshtur që kurse u dyndën në viset ilire, duke u dhënë Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim, lehtësimin e regjimit të vizave, statusin “kandidat” dhe negociatat për anëtarësim në BE, përkundër Shqipërisë dhe krahinës së saj jashtëzakonisht madhore dhe vendimtare në shtetin e Vlorës, Kosovës. Tash duhet t’u përgjigjim me zgjedhjen që lamë heshtazi kundër vetes dhe lehtazi asaj dynjaje dhe çapaçulëve që mbështesin ecjen ndarazi. Kur sheh se asgjë nuk e ndryshoi sjelljen e Evropës ligësimadhe sigurisht edhe me çka na bën Haga, besoj se çapaçulët kanë rast të këndellen e të bëhen syhapur se të jemi bashkë nuk është armiqësi, madje duke ua përbuzur idiotësitë për gjuhë, simbole apo “kosovarizma” ofendues për mbarë shqiptarinë. Nuk ka lidhje Hashimi apo Kadria dhe as tërë aradhja jonë e dërguar orë e çast me poshtërsi evropiane nëpër gjyqe që dështuan. Ka lidhje se ulëm kokën duke pranuar çdo gjë, madje duke i dhënë një tufe çapaçulësh të

pafajshëm naivë të idesë liganake, se ndarazi ne bashkohemi. Me kast e vendosa sot këtë shkrim sepse është pandarazi me krejt Shqipërinë që ka ditën e zezë të gjenocidit grek në krahinën jugore të Çamërisë, njohur nga Kuvendi i Shqipërisë ky 27 qershor 1944 kur Paramithia u bë vatër e 660 viktimeve dhe përfundoi me sa e sa të tjera viktime dhe shfarosjen e më shumë se 40 mijë çamëve tanë. Këtu nuk po përfshi fare dhjetëramijëra të tjerë të shkatërruar, vrarë, masakruar, pre e gjenocidit në vitet 1920-1930 dhe të pushtimit të Artës nga kriminelët grekë në 1876 e tutje. Pra nuk e ndaj dot çapaçulazi verilindjen, jugun, veriun, lindjen nga Shqipëria. Jam shumë i lumtur që do ta lexojnë me inat dhe mlllef këtë postim meqenëse, sipas kundërshtarëve shtetdashës të një pjese të Shqipërisë, bën të duket se unë prirem që Shqipëria të jetë paternaliste. Nuk është paternalizëm kujtesa se çfarë dhe e kujt është Kosova dhe Çamëria, Malësia nën pushtimin malazez dhe lindja e nëpërkëmbur prej maqedonasve, verilindja e Epërme prej Nishit e Preshevës me tërë Luginën dhe Vranjën e teposhtë. Pra, lumturohem që do ta lexojnë mlllefplot se sepse kjo tregon se ata që shqetësohen thjesht janë çapaçulët. Te këta hyjnë frikacakët lëpirës të Shqipërisë që vrasin veten duke pranuar kufijtë e Londrës. Ata nuk e zhbëjnë dot faktin e akteve madhore të pashfuqizuara kombëtare se Shqipëria nis e mbaron në Prizren dhe Vlorë.

I nderuar president, qëndroji pranë figurës suaj



Shkruan: Ekrem BARDHA

I nderuar zoti president Thaçi, E di dhe jam i bindur se momenti i tanishëm në jetën tuaj politike dhe qytetare mund të jetë i vështirë, po aq sa jam i bindur se ai nuk do të ndryshojë disa të vërteta historike, të cilat, pavarësisht nga dëshirat jashtë Kosovës, janë përcaktuar qartë dhe kanë zënë vend në kujtesën e kombit. Duke qenë një ndër përkrahësit më të vendosur të pavarësisë së Kosovës, që në krye të herës kur pak vetë guxonin ta ëndërronin këtë, kam mbështetur fuqimisht,

pa asnjë ekuivok, deri në instancat më të larta të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në takime të veçanta me presidentë dhe ish-presidentë, senatorë dhe kongresmenë, luftën e drejtë, liridashëse dhe sakrifikuase të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila ishte dalëzotëse e popullit. Kam qenë gjithnjë i bindur dhe vazhdoj të jem se ajo ishte një luftë sa e domosdoshme aq edhe e drejtë; mbarëpopullore dhe kombëtare, për aspirata të mëdha dhe rrugë drejt bashkimit të kombit; kam qenë dhe vazhdoj të jem i bindur se UÇK-ja, në qëllimet e saj, luftimet, përcaktimet kombëtare, aksionet dhe në të gjithë veprimtarinë e saj nuk ka bërë shkelje të ligjeve ndërkombëtare. Ndryshe nga ushtria serbe, policia dhe shërbimi sekret serb, të cilët masakruan rreth 15 mijë shqiptarë të

Kosovës, fëmijë, gra, burra, pleq, dëbuan rreth 1 milion shqiptarë nga trojet e tyre etnike, vranë, grabitën, dogjën, dhunuan, krejt ndryshe veprimi UÇK-ja, ku ju ishit drejtori politik i saj, të cilët, edhe pas kaq viteve hulumtime, sajesa e mashtrime, shteti serb nuk arriti të mbledhë të dhëna as për 100 veta dhe jam i bindur, prova të sajua dhe të fabrikua. Unë, si qytetar amerikan-shqiptar, që kam pasur nderin t’ju takoj, të bisedoj me ju, ta ndjek politikën tuaj në dobi të kombit, të dekorohem nga ju për aktivitetin tim, qëndroj pranë figurës suaj, jo vetëm si mbështetje, por edhe si dëshmi e qëndrimit të lartë politik, diplomatik dhe ushtarak që solli politika e lartë e Shteteve të Bashkuara. Që pas mbarimit të luftës në Kosovë, ku, për herë të parë, një

strukturë e armatosur luftarake shqiptare, si ishte UÇK-ja, u bë pjesë e koalicionit të madh ndërkombëtar kundër fashizmit serbomadhi dhe politikës gjenocidiale të Millosheviqit, shumë akuza janë bërë mbi figura të larta të drejtimit të UK-së, por gjithëherë është dëshmuar pafajësia e komandantëve të luftës dhe lufta e drejtë e UÇK-së. Tani, i nderuar zoti president, po luhet një akt tjetër i akuzimit të luftës çlirimtare, por do të jetë edhe një provë e re e drejtësisë së luftës, e qëndrimit tuaj parimor, si drejtues lufte dhe burrë shteti. Më lejoni zoti President t’ju afroji gjithë mbështetjen time, si qytetar dhe njeri i angazhuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, duke besuar në luftën e drejtë, të pastër e burrërore të UÇK-së, ku ju ishit drejtues i saj!

Sot fillojnë punimet rrugore në lagjen “Arbanë” të Prizrenit

PRIZREN, 28 QERSHOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se sot (e hënë) do të fillojnë punimet për ndërtimin e rrugës në lagjen “Arbanë” të kësaj komune. Me këtë rast, kjo komune ka theksuar se rruga

“Transiti”, që lidh lagjen “Arbanë” me hyrjen e autostradës - transitin e Petrovës - do të jetë e bllokuar për shkak të zhvillimit të punimeve. “Të nderuar qytetarë, të hënën do të fillojnë

punimet për ndërtimin e infrastrukturës rrugore në lagjen ‘Arbanë’. Me këtë rast rruga ‘Transiti’, që lidh lagjen ‘Arbanë’ me hyrjen e autostradës - transitin e Petrovës, do të jetë e bllokuar për shkak të zhvillimit

të punimeve. Në fotografi mund ta gjeni aksin e rrugës ku do të zhvillohen punimet si dhe rrugët alternative që do mund të shfrytëzohen. Punimet do të vazhdojnë për 5 ditë”, ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



Prishtina ndihmon me 5 milionë euro rreth 20 mijë biznese që pësuan nga Covid-19

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka marrë vendim t’u dalë në ndihmë me mjete financiare, rreth 5 milionë euro, bizneseve të vogla dhe të mesme me rastin e dëmtimeve për shkak të Covid-19. Rreth 20 mijë biznese do të kenë mundësi të përfitojnë nga kjo pako, duke përjashtuar ato të cilat kanë përfituar nga Pakoja Emergjente Fiskale. Nën kryetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi, ka thënë se kjo pako është aprovuar që nga muaji prill, mirëpo për arsye politike Ministria e Financave nuk ka

arritur ta përcjellë deri në Kuvendin e Kosovës. Më tutje, ai ka bërë me dije se nga tani bizneset do të mund të aplikojnë për të përfituar nga kjo pako. “Kjo pako aktualisht ende nuk ka filluar. Pakoja fillimisht është aprovuar në mbledhjen urgjente të Kuvendit Komunal në muajin prill, por që për arsye politike nuk arriti Ministria e Financave ta përcjellë deri në Kuvendin e Kosovës, me ç’rast është dashur të aprovohe bartjet e mjeteve nga investimet kapitale në granatet e parapara për bizneset e dëmtuara gjatë



pandemisë. Në mbledhjen e fundit të Kuvendit Komunal janë aprovuar bartjet e këtyre mjeteve, pas konsultave edhe me Ministrinë e Financave. Ne dje e kemi marrë edhe ligjshmërinë nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, prandaj prej sot jemi në gatishmëri ta nisim aplikacionin, i cili u mundëson bizneseve të aplikojnë për format e grandëve të ndryshme”, ka thënë Nushi për “Kosovapress”. Ai ka thënë se nga kjo pako pritet të përfitojnë 19 920 biznese të regjistruara në ATK.

Në Gjilan do të bëhet faza e parë e dezinfektimit hapësinor



GJILAN, 27 QERSHOR (ER) - Komuna e Gjilanit ka bërë të gjitha përgatitjet për ta filluar fazën e parë të dezinfektimit hapësinor, ku këtë vit është paraparë që ky projekt të bëhet në tri faza.

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e cila menaxhon këtë projekt, ka konfirmuar se të gjitha përgatitjet janë bërë që faza e parë të nisë më 30 qershor nga ora 19:30 deri në orën 24:00. Kjo komunë ka theksuar se gjatë kohës së dezinfektimit qytetarët duhet t’i mbajnë dritaret e mbyllura, që mos të futen insektet brenda si dhe një kujdes të veçantë duhet ta kenë edhe bletarët. “Njoftohen bletarët për kujdes të shtuar, që t’i mbajnë të mbyllura bletët prej orës 19:30 deri 05:00 të mëngjesit gjatë këtyre ditëve për shkaqe sigurie.

Dezinsektimi fillon nga lagja ‘Zabeli’, përkatësisht nga kolektori ku zakonisht është burim i mushkonjave dhe insekteve të tjera, për të vazhduar përgjatë lumit ‘Mirusha’, në të dyja anët e tij deri në qendër të qytetit. Po ashtu, do të përfshihet lagja ‘Reshat Ymeri’, Dheu i Bardhë. Në ditët në vijim do të përfshihen lagjet e tjera si: ‘Dardania’, ‘Kodra e Dëshmorëve’, ‘Bregu i Djegur’ si dhe tërë lagjet e hapësirave tjera të qytetit”, ka njoftuar Komuna e Gjilanit.

Këtë vit janë të përfshira edhe zonat rurale ku ka potencial të lartë të zhvillimit të këtyre insekteve sidomos rreth lumenjve të fshatrave Malishevë, Uglarë, Pogradjë, Dobërcan, Përlepnice, Livoq i Epërm, Livoq i Ulët, Cërnicë, Lladovë, Zhegër, Llashticë dhe Velekincë.

“Jetimat e Ballkanit” dhe Komuna e Podujevës do t’i ndërtojnë 26 shtëpi për familjet në nevojë

Podujevë, 28 qershor (ER) - Nën kryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me udhëheqësin e Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”, Halil Kastrati, për ndërtimin e 26 shtëpive për familjet në nevojë të kësaj komune, të cilat nuk e kanë të

zgjdhur çështjen e banimit. Me këtë rast, nënkryetari Rudari ka bërë me dije se vlera e projektit është 520 mijë euro. “Komuna e Podujevës do të participojë me 130 mijë euro, kurse pjesa tjetër do të jetë investim i Shoqatës ‘Jetimat e Ballkanit’”, ka thënë Rudari, i cili e ka falënderuar human-

istin Kastrati. Ndërsa Kastrati është shprehur i lumtur me nënshkrimin e këtij memorandum, duke falënderuar nënkryetarin Rudari për bashkëpunimin. Ai ka thënë se do ta vazhdojë bashkëpunimin me Komunën e Podujevës edhe në projekte të tjera. Krahas këtij projekti në

Komunën e Podujevës është duke u finalizuar projekti i ndërtimit të shtëpive të banimit social në lagjen e “Dëshmorëve”, ku brenda pak ditësh do të fillojë ndërtimi i 22 shtëpive nga projekti i përbashkët i Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.



ANGLEZI QË I DHA KUPTIM GAZETARISË DHE LETËRSISË BOTËRORE

Recenzion: Bernard Crick: George Orwell – A Life (George Orwell – Një Jetë);
Botoi: Penguin Books, London 1992.



Daut DAUTI

Nga shumica e kritikëve letrarë kjo biografi e George Orwell-it, e shkruar nga Bernard Crick, konsiderohet ndër më të kompletuarat dhe më të mirat. Jeta e Orwell-it, e paraqitur që nga fëmijëria e hershme e deri te vdekja, shtrihet në XVII kapituj që shpalosen në 675 faqe.

George Orwell (emri i vërtetë Eric Blair) ka lindur në Indi në vitin 1903, ku babai i tij ishte shërbyes civil në administratën e Perandorisë Britanike. Pas një viti ai u soll për t'u rritur dhe arsimuar në Angli. Pasi që e kreu shkollimin në "Eton College", duhet theksuar se ishte i pajisur me shkollim të cilësisë sipëror. Për shkak të mungesës së parave nuk pati mundësi t'i vazhdonte studimet universitare. Pas kryerjes së kolegjit shkoi në Birmani, ku u punësua në Policinë Imperiale të Indisë.

Pas disa vitesh u kthye sërish në Angli, pastaj shkoi në Spanjë, së bashku me Eileen, gruan e tij të parë, për të marrë pjesë në luftën civile në anën e republikanëve antifrancoist. Me 20 maj 1937 u plagos në qafë, një ngjarje që e shpjegoi në esenë "Wounded by a Fascist Sniper" (I plagosur nga një snajperist fashist) dhe në novelën "Homage to Catalonia" (Homazh Katalonisë). Pas kësaj ngjarjeje kthehet në Angli, në atë kohë me ndryshim të madh në pikëpamjet e tija politike, por edhe në intensifikimin e krijimtarisë letrare.

Sa i përket veprimtarisë së tij, nga kjo biografi marrim vesh se shkrimtari dhe gazetari anglez, George Orwell, ka shkruar nëntë libra, dy përmbledhje me ese të shkurtra dhe disa qindra recensione, letra dhe shkrime të tjera që përbëjnë artikuj të gazetarisë. Në disa raste janë publikuar të gjitha veprat e tij, që përfshijnë 20 vëllime. Për një shkrimtar gjigant dhe gjenial si Orwell-i, i cili e vulosi letërsinë me stilin e tij, mund të thuhet se ky numër i veprave nuk është i vogël as nga kuantiteti.

Arsyeja që sot nuk kemi më shumë vepra të tij, është jeta e shkurtër dhe sëmundja nga e cila ai vuajti një kohë të gjatë. George Orwell-i jetoi vetëm 46 vjet. Por, jeta që ka bërë ai deri në pedestal ka qenë e vështirë. Deri vonë varfëria i rrinte mbi qafë, gjë që i shkaktoi edhe shëndet të ligë, nga i cili

vdiq relativisht i ri. Për të mbijetuar iu desh të shkruante në shumë gazeta dhe, madje, të argumentonte për të njëjtën dukuri nga pozita të ndryshme. Sasi të madhe të kohës i mori edhe pasioni që kishte për jetën në fshat, kopshtarinë, kujdesin për kafshët shtëpiake, peshkimin dhe zdrukthëtarinë.

Bernard Crick në këtë libër biografik e njofton lexuesin me të arriturat dhe karakterin e Orwell-it si njeri dhe si shkrimtar. Ai e sheh Orwell-in si një njeri të madh, i cili ishte shumë i suksesshëm edhe pse pati jetë të shkurtër. Brenda kësaj kohe të shkurtër Orwell-i u ngrit nga një shkrimtar dhe gazetar i panjohur në një personalitet shumë të rëndësishëm në Angli, kurse pas vdekjes u bë edhe figurë qendrore në letërsinë botërore. Popullariteti i tij pas vdekjes ka qenë gjithmonë në rritje. Në këtë horizont kaq të madh të shtrirjes së tij, e tillë është edhe influenca që ushtroi në Angli dhe në botë. Influenca e tij, që ndodhi pas vdekjes, është shfaqur në domenin e politikës, në të cilën ai ka ndikuar me anë të zhvillimit të nocionit të lirisë dhe tolerancës si kategori dhe koncepte jo vetëm të kuptimit politik, por edhe të atij filozofik. Siç shihet në kapitullin XI të këtij libri, kjo e bëri Orwell-in shkrimtar politik. Orwell-i ushtroi ndikim edhe nga fakti që ishte në gjendje të pranonte ose refuzonte ndonjë risi letrare ose artistike, që tentonte të hynte në rrjedhat kryesore të lëmenjve përkatës. Orwell-i ishte i pari që e kuptoi "Uliksin" e James Joyce-it dhe e çmoi lart këtë vepër dhe autorin irlandez. Kjo ndodhi atëherë kur gazetatat angleze dhe "intelektualët" e këtij vendi "Uliksin" dhe Joyce-in i quanin fëlliqësirë. Ai e lavdëroi artin e Henry Miller-it, por e shau për shkak që ai shfaqte një cinizëm të qëllimshëm jopolitik. E përkrahu shpërblimin që iu dha Ezra Pound-it për vepër artistike, edhe pse e urrente publikisht si person, të cilin e quante fashist, kriminel lufte, etj. Pra, Orwell-i bëri me dije që personaliteti dhe vepra janë dy njësi, të cilat, për të, shkonin ndaras.

Në lidhje me përkatësinë kombëtare, ai e quante veten anglez dhe nuk dëshironte t'i thoshin se ishte britanik. Në këtë vepër, Bernard Crick-u thotë se Orwell-i në veprat e tij e ka paraqitur karakterin anglez. Këtë thënie të tij ai e bazon në dy studimet që i ka bërë Orwell-i, të cilat janë: "Lion and the Unicorn" (Luani dhe Njëbrirëshi) dhe "The English People" (Populli Anglez). Bernard Crick-u, si biograf me renome i Orwell-it, insiston që këto dy vepra janë ndër studimet më serioze në lidhje me karakterin kombëtar të


anglezëve. Ai thotë se Orwell-i është superior ndaj mendimeve dhe veprave të Arthur Bryant-it dhe Winston Churchill-it, që kanë shkruar për këtë çështje.

Orwell-i ishte edhe mendimtar politik i llojit të vet. Crick-u vërteton se një gjë të tillë Orwell-i e ka paraqitur në veprën e tij "1984", ku ai themelon një model për historianët e ekonomisë dhe për shkencëtarët shoqëror, duke i sfiduar këto dy lëmi për krahasim. Një gjë e këtillë paraqet një logjikë ironike dhe një vazhdimësi të brendshme me 'Leviathan-in' e Thomas Hobbes-it, e cila është kryevepra e filozofisë politike angleze.

Para se të shkonte në luftën e Spanjës, George Orwell-i e themeloi konceptin e totalitarizmit duke i pasur parasysh

politikën diktatoriale të Hitlerit dhe Stalinit. Më vonë, pas dy dekadave, për totalitarizmin folën dhe shkruan edhe Hanna Arendt, Carl Friederich dhe Zbigniew Bzhezinski, por nuk treguan kurrë nga ku e kishin marrë termin dhe domethënien e tij.

Ndikimi i tij në të gjitha format e të shkruarit ishte aq i madh sa që shpjegimet e situatave politike të komplikuar, të veçanta, të paimaginueshme ose joreale, që bëhen nën regjinë e shtetit, morën emrin e tij – oruelliane. Një term i tillë gjeti përdorim edhe në rastin e Kosovës. Mund të na kujtohet që tendencën e Millosheviqit që të zhdukte identitetet individuale (ndoshta edhe kolektive) dhe zhdukjen fizike të shqiptarëve, zëdhënësi i NATO-s, Jamie Shea, e quajti oruelliane. /Telegrafi/



E jashtëzakonshme

Delfinët mësojnë si njeriu

Delfinët mësojnë në mënyrë shumë të ngjashme me majmunët e mëdhenj. Sjelljet e tyre të ngjashme, kryesisht me gorilla dhe shimpanzetë, i mësojnë jo vetëm nga prindërit, por edhe nga grupet e tyre, ka shpjeguar një studim i publikuar në revistën "Current Biology".

Një grup kërkuesish kanë vrojtuar sjelljet e tyre në brigjet e Australisë, veçanërisht kur janë në kërkim të ushqimit. Rezultoni se këto sjellje janë shumë të pazakonshme dhe nuk mësojnë vetëm nga nëna, siç mendohej deri më sot, por edhe nga pjesëtarët e tjerë të grupit apo bashkëmoshtarë. Por edhe përdorimi i instrumenteve që i shërbejnë



për ta arritur qëllimin e tyre është mjaft i ngjashëm me arsyetimet e majmunit dhe njeriut. Sipas studiuesve të kësaj pune kërkimore, ky zbulim është mjaft i rëndësishëm, pasi vërtetohet se sjellja kulturore e delfinit është shumë më e ngjashme pra me gjallesat më inteligjente, majmunët antropomorfë, përfshirë njeriun.

BARSOLETA E DITËS



Djali: Zemër, ta kam blerë një dhuratë për ditëlindje.

Vajza: Uaooo çfarë befasi!

Djali: E sheh atë 'Ferrarin' me ngjyrë të kuqe.

Vajza: Të dua shpirt pa fund.

Djali: Si ajo ngjyrë e veturës ta kam blerë një bluzë.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

Modelja shqiptare sjell fotosesion sensual nga Amerika

Për momentin është njëra prej modelëve shqiptare më të kërkuara në Amerikë

Bëhet fjalë për Lorena Halitin e cila këto ditë ka mbajtur disa fotosesione në Amerikë.


I tillë është edhe fotosesioni i fundit i Lorenës në të brendshme e ku bukuroshja kosovare

tregon potencialin e saj.

Ajo shfaqet në të brendshme të zeza derisa tregon vetëm pak nga ky fotosesion derisa ka edhe një cigare në gojë.

Lorena ka qenë aktive edhe gjatë pandemisë COVID-19, por tani ajo ka filluar të jetë edhe më aktive.

FOTO E DITES



Qytetarët në Singapor respektojnë masat anti-Covid. /Reuters/

E rrallë

Almihan Seyiti, gruaja më e vjetër në botë

Almihan Seyiti është gruaja më e vjetër në botë, e cila së fundmi ka festuar ditëlindjen e 134-t. Ajo është nga Kina dhe thuhet se është njeriu më i vjetër në botë dhe personi i parë në histori me kaq vite jetë. Gruaja e moshuar thuhet se ka jetuar në tre shekuj dhe ka përjetuar dy luftëra



botërore. Në vitin 1903 zonja Seyiti u martua në moshën 17-vjeçare dhe më pas, së bashku me bashkëshortin, birësuan një djalë dhe një vajzë. Ajo jetoi me të bijën, pasi bashkëshorti ndërroi jetë në vitin 1976, ndërsa i biri humbi jetën në moshën 36-vjeçare.



 <p>DASHI Jeni energjik, të vendosur në pozicionet e duhura dhe do t'ju rrisë besimin tuaj. Do të arrini të bëheni një pikë referimi e rëndësishme për shumë njerëz rreth jush.</p>	 <p>DEMI Ditë interesante për të gjithë ju që do të jeni në gjendje ta menaxhoni mirë, duke kontrolluar nxitimin dhe frymën kritike.</p>	 <p>BINJAKËT Dy lajme të mira. I pari që u jep fund armiqtëve me shenjën e Peshqve: forma fizike dhe çështjet profesionale rifitojnë lartësi dhe rëndësi.</p>	 <p>GAFORRJA Dita sot do të sjellë një orientim të përkohshëm për të punuar, veçanërisht nëse keni një veprimtari të pavarur. Jeta në çift gjithashtu do të kërkojë më shumë vëmendje sesa zakonisht.</p>	 <p>LUANI Ditë shumë pozitive. Do të gjendeni nëpër qytete turistike ose rrugës për në plazhin tuaj të preferuar, në male, kodra, në det ose liqen. Zhytuni në bukurinë e peizazheve dhe shijojeni në maksimum.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Gjithçka bëhet më e lehtë e më e butë: do t'i gjeni zgjidhjet më të mira për problemet që ju shqetësojnë më shumë, do ta rivendosni vullin dhe intensitetin në marrëdhënien me partnerin.</p>
 <p>PESHORJA Jeni gati të krijoni grindje në marrëdhënie me partnerin tuaj, do të vejë në dyshim disa aspekte të marrëdhënies suaj romantike.</p>	 <p>AKREPI Do të përballeni me luhatje. Fajin e ka Hëna që sjell pengesa dhe konfuzion. Reflektimi nuk duhet të jetë një justifikim për ta kultivuar melankolinë sepse mund të kthehet në depresion.</p>	 <p>SHIGJETARI Përfitoni sepse është një moment i përkryer. Ndryshime të favorshme priten në sektorë të shumtë. Takime magjike, të rëndësishme për beqarët.</p>	 <p>BRICJAPI Kini parasysh tensionet në shtëpi, në familje dhe shëndetin fizik që nuk do të jetë gjithmonë në krye.</p>	 <p>UJORI Pjesëmarrja, entuziazmi dhe dinamizmi kapërcejnë sot. Emocione shumë të forta ju presin në fushën e dashurisë, pavarësisht gjendjes suaj.</p>	 <p>PESHQIT Nevoja për t'u përballur me çështje praktike ju detyron të jeni me këmbë në tokë. Do të gjeni kohë për interesat dhe hobin tuaj.</p>


Margot Robbie, piratja e radhës e ishujve të Karaibeve



Jemi mësuar gjithnjë që të shikojmë aktorë meshkuj teksa interpretojnë sagën më të famshme "Piratët e Karaibeve", por këtë herë ndryshimi është vërtet thelbësor. Aktorja australiane Margot Robbie do të jetë piratja e radhës e ishujve të Karaibeve, e cila do ta interpretojë femrën e fuqishme dhe të pamposhtur. Robbie, edhe pse 29 vjeç, është aktorja më aktive e Hollywoodit, në vetëm pesë vjetet e fundit ka marrë pjesë në 19 filma si protagonistë


dhe joprotagoniste. Rolet më të rëndësishme janë në filmat: "Once Upon a Time a Hollywood", "Bombshell", "Mary Queen of Scots" dhe "Tonya", në të cilët ka marrë edhe nominime për Oscar, Golden Globe dhe BAFTA Awards. "Piratët e Karaibeve" është një ndër filmat më të shikuar të të gjitha kohëve. Pjesëmarrja e Margotit shënon ofertën e fundit që Hollywood bën për të promovuar aktoren femër.

Mimoza Shkodra 'mahnit' me format trupore derisa pozon atraktive në bikini



Mimoza Shkodra ka pozuar në mënyrë atraktive. Ajo njihet për suksesin në muzikë. Duke qenë kështu, falë zërit e afërsisë që ka me njerëzit, Mimoza ka arritur të mbledhë një

numër jo të vogël të fansave. Këngëtarja me ndjekësit në llogarinë e vet në "Instagram" ndan shpesh imazhe të ndryshme. Së fundmi ka treguar trupin derisa ka pozuar joshëse në bikini.



Enca fton të gjithë në dasmën e saj: Më e madhja në shqiptari

Enca Haxhia ka befasuar me postimin e fundit. Këngëtarja e njohur shqiptare, Enca Haxhia, duket se ka filluar t'i bëjë planet për dasmë ende pa e gjetur partnerin. Ajo para publikut dhe mediave ka kohë që deklarohet "single", ndërsa ende nuk ka pasur zëra se është parë së fundmi në krahët e ndonjë mashkulli. Megjithatë, këngëtarja ka lënë të kuptohet se e do një dasmë të madhe dhe i ka ftuar të gjithë të marrin pjesë. Lajmin e ka bërë publik në "Instastory" të "Instagramit".



Emily Ratajkowski bëhet bionde



Modeluesja e njohur vazhdon të postojë foto të nxehta në rrjete sociale. Thuhet se kur një grua pret flokët, ka probleme në dashuri. Por ky nuk është rasti Emily Ratajkowski e cila ka shokuar fansat me ngjyrën e re të flokëve. Nga brune e çelët, modeluesja është kthyer në bionde. Por kjo nuk e ka bërë të heqë dorë nga vesi i saj i preferuar. Fotot e nxehta, thuajse nudo, në rastin më të veshur me bikini. As ngjyra bionde e flokëve nuk zbehu vëmendjen e fansave për linjat e saj perfekte trupore. Sharmi i britanikes 29-vjeçare nuk varet aspak nga ngjyrat, sekretit qëndron te performanca.

Biçikleta



12 prill 1991, Tiranë, Shqipëri: Fëmijët e varfër kërkojnë lëmoshë nga besimtarët që dalin nga Xhamia e Et'hem Beut (foto: Barry Lewis/In Pictures/Corbis)

Biçikleta ishte një rraqe metalike pa moshë. Si sot edhe para, edhe pas dhjetë vjetësh mbetej gjithmonë as e re as e vjetër.

Biçikleta ishte një "imobiliare" e lëvizshme që trashëgohej, shitej, falej, këmbehej, vidhej, flinte, zgjohej, plagosej, rënkonte, sëmurej, shërohej, por kurrë nuk vdiste.

Biçikleta në shitje kishte aq rrallë sa nuk mbahej mend kur kishte ndodhur.

S' dihej kush e kur e ku e kishte blerë biçikletën. Biçikleta gjallonte në anonimitet të thellë, si breshka brenda zhuqullit.

Biçikleta ishte sendi më i lakmueshëm për t'u vjedhur. Biçikleta vidhej më tepër se gjithçka. Vjedhja e biçikletës ishte fatkeqësi nga më të mëdhatë që mund të pllakosnin. Për ta lidhur biçikletën pas ndonjë shtylle për mos ta vjedhur, përdoreshin një amanejarebi me dryna, kavo, litarë, zinxhirë.

Nëse ndodhte që po atë ditë kur të vidhnin biçikletën të vidhnin edhe antenën apo diçka tjetër, kupa derdhej, jeta sterrosej.

Një herë e një kohë biçikleta kishte targë dhe një si tesër. Pse? Një Zot e di. Ndoshta kishin kopjuar Kinën ose Rusinë ku biçikletat ishin me miliona.

Shqiptarin barkzbrazur veshur keq me një biçikletë përdore duke

u endur nëpër Tiranë, atë kryevepër nuk doli asnjë Mikelanxhelo ta pavdekësonte në mermer.

Pse nga Rusia prej kah vinin turllilolj hekurishtash nuk erdhën kurrë biçikleta? Askush nuk e dinte.

Biçikleta e parë më e përhapur quhej "Diamant". Thoshin se e kishin sjellë nga Gjermania Lindore duke e këmbyer me domate e kastraveca.

Pastaj sollën "Mifa", e ngjashme me "Diamant"-in, por jo aq e fortë.

Biçikletat kineze që i sollën me shumicë në vitet 1970-80 kishin të pikturuara ca gjarpërinj, nuk kishin emër. Quheshin të gjitha "biçikletë kineze".

Biçikletat ishin dy llojesh;

Me hekur, të cilës nuk mund t'i hipnin femrat se u dukeshin brekët dhe bëhej hataja.

Pa hekur, demek tip "Vespa", që mund të përdorej pa frikë nga femra e meshkuj edhe pa brekë.

Mirëmbajtja e biçikletës s' ishte problem. Për mirëmbajtjen e biçikletës zbatoheshin me sukses parimi "kam te puna". Nëse duke ndrequr biçikletën "te puna", ndodhte që andejpari kalonte brigadieri, shefi, drejtori, ata jo vetëm s' të pengonin, por të shihnin me dashamirësi.

Ndonjëherë biçikleta ishte shpëtimtare.

I thanë njërit: Mbetë me biçikletë a ditëzi. E ke që e ke një kushëri në Greqi. Thuaji të sjelli një motoçikletë?

Ua priti miku: Jo. Kurrë. Tani që lëviz me biçikletë, më vënë nga pas një spiun me biçikletë, dhe janë të qetë që nuk do arratisem apo nuk do bëj ndonjë herezi tjetër. Po të marr motoçikletë, unë me motoçikletë, spiuni im me motoçikletë, do binte në sy. Të më vënë pas mua me motoçikletë një spiun me makinë është shpenzim që nuk ia vlen, përkujdesje që nuk e meritoj, dhe më degdisin në Spaç.

Sado rraqe që ishin, shumica e biçikletave kishin një fener elektrik për të ndriçuar rrugën për tu ruajtur nga trafiku inekzistent. Kotësia e fenerit nuk u vu në dukje kurrë. Për të kujtuar se Shqipëria ishte "fener ndriçues i botës", ndonjëherë në mbrëmje polici të thoshte "ndize dritën".

Varkat, gomonet, kamerdaret, krahët e Ikarusit, mjete arratisjesh dalë me tërsëllëmë nga cirkomvolucionet e ndezura gjatë delireve nocturne me sytë në tavan, me gjithë ato pedale, timona, zinxhira, rrotëza, ishin të frymëzuara nga biçikleta.

Ekzistonte një kilometrazh i vogël sa një kokërr arrë mbërthyer te piruni i biçikletës pranë aksit të rrotës. Askush nuk e pa kurrë sa

kilometra shënonte kilometrazhi. Pse mjeti ekzistonte, por rruga shtëpi-punë-shtëpi e përshkuar mijëra herë nuk u mat kurrë?! Mbeti mister.

Nga pjesët e biçikletës më e famshmja dhe më e llafosura ishte "shala".

Më e afërt, më konfidenciale, më intime se me shalën, shalimin, shalët e asaj apo të atij, biçikleta ishte me bythën e atij ose asaj që shalën e kishte shaluar.

Cilësimi "shalë" dhe jo "bythë", kjo padrejtësi ndaj bythës në kurriz të shalës, mbetet i diskutueshëm sot e kësaj dite.

Pavarësisht nga cilësimi i padrejtë, në memorien kolektive shqiptareske, shala mbeti e paharruar si "rehati mikroborgeze" e paevitueshme, mungesa e të cilës sillte telashe, shkaktonte çvirgjërimin e pavullnetshëm si nga para dhe nga mbrapa të vajzave dhe të djemve. Zgara e biçikletës, megjithëse pa ndonjë lidhje karnale, ishte gjithaq e rëndësishme sa edhe shala. Në zgarë mbahej zakonisht ajo që quhej "bukë me vete". Ndonjëherë mbi zgarë rrinte graja. E cila, për shkak të ndonjë grope apo gunge të rrugës ndonjëherë rrezohej, dhe burri që ngiste biçikletën, rrëzimin nga zgara të gruas, nuk e ndjente, vazhdonte rrugën. Kthehej ta

gjente e ta merrte gruan e rrëzuar nga zgara e biçikletës si kthehem të gjejmë ndonjë send që na ka rënë nga xhepi.

Disqet, telat, zinxhiri, pedalet, kontrapedali etj. sado të vjetër e difektozë s' ishin problem.

Problem ishin kamerdaret dhe kopertonat. Por, u bëhej dermani. Kamerdaret mbusheshin me pulla mbi pulla si arna mbi arna për shumë vite.

Kopertonat arnoheshin nga brenda dhe qepeshin me spango, derisa s' kishe çfarë të arnoje se kopertoni bëhej arnë i tëri.

Pse aksi i koronës është pak më poshtë se pinjoni?

Sepse zinxhiri duhet të tërheqë horizontalisht.

Pse aksi i timonit është i pjerrët përpara?

Që të vazhdojë moda e dhënies së biçikletës "pa duar".

Un' pyesja, un' përgjigjesha.

Aq e dashur, e urtë, besnike, ishte rraqa biçikletë, sa edhe në filmat e luftës imagjinare nacional çlirimtare halabakët atentatorë nëpër rrugica nuk paraqiteshin kurrë mbi kuaj, apo gomerë, apo makina, vetëm mbi biçikletë.

Biçikleta në mes të kurrkundit i gjeti, në mes të asgjësë i la. Derisa shqiptarët rraqen biçikletë e hodhën tutje. U derdhën nëpër ambasada. U ngjitën mbi trageta.

/Telegraf



Ismail Kadare: Elegji për artin

Parathënia e albumit "Vilson Kilica – Një jetë në krijimtari", tetor 2012

Pëlhurat e pambaruara, bocetet, ashtu sikurse sinopset. Thelbi i veprave që për arsye të ndryshme nuk u shkruan, dëshmojnë shpesh për artistin po aq sa edhe veprat e kryera. Është një bocet i Vilson Kilicës që tërheq vëmendjen e veçantë në galerinë e tij, "Vdekja e piktorit". Vëmendje e veçantë në këtë rast nuk do të thotë se ky bocet ia ndryshon natyrën veprës së tij, pikturave, e aq më pak se e sfidon atë ose e zbërthen në një dritë të re. Kjo spikamë e trishtë e një dite të zymtë e me shi, në

të cilën është varrosur piktori dhe miku i tij, Jakup Keraj, është pjesë e veprës së Kilicës. Madje ndër ato që sundonin ndoshta qendrën e saj.

Jakup Keraj, ashtu si vetë Vilson Kilica, ashtu si Ksenofon Dilo, Danish Jukniu, Sali Shijaku e piktorë e artistë të tjerë, disa prej të cilëve kam pasur rastin t'i njoh e t'i kem miq, bënë pjesë në atë valë krijuesish të rinj, që u kthyen pas studimeve në Shqipëri, vendin më të ashpër të botës komuniste. Iluzionet e rreme të një zbutje-

je, pas dënimeve të krimeve të Stalinit e, fill pas tyre, deziluzioni edhe më i hidhur i një zbutjeje e një europianizimi të rastësishëm të Shqipërisë pas shkëputjes nga kampi socialist, do të pahitnin në mënyrë të druajtur, por të vijueshme, artin shqiptar.

Boceti "Vdekja e piktorit" do të ishte ndoshta një elegji e qetë për artin, që nuk arriti të kryhej, për mundësitë, për pengun e gjithçkaje, që nuk arriti të dilte në pëlhurë, në muzikë a në rrëfim letrar. Ai që u quajt "art i

realizmit socialist", stinë pas stinë dhe vit pas viti u përpoq të zinte e të sundonte gjithë hapësirën shqiptare. Këtë sundim e shpallte propaganda e kohës, krenohej me të, profetizonte përjetësinë e tij. Mirëpo nuk ndodhi ashtu. Ashtu si gjithkund në ish-perandorinë komuniste, ashtu si në vitet e terrorit stalinist në Rusi, Hungari, Çeki e kudo, edhe në Shqipëri shteti nuk vuri dot plotësisht në gjunjë artin. Aty-këtu, midis klimës së ashpër, fare të papërshtatshme për art e

aq më pak për hyjni, shfaqeshin papritur tekste letrare, pëlhura dhe muzikë, që herë haptazi, por më shumë tërthorazi, e sfidonin shterpësinë e kohës. Një brengë njerëzore, një ardhje dimri, një peizazh i pikëlluar apo portretet e gruas së dashur, ashtu si lulet e pakta, të mbira në truall të vështirë, na duken ndoshta edhe më të çmueshme sot. Ky album i Vilson Kilicës, piktorit të pajisur me finesë dhe vetëpërmbytje dinjitoze, e dëshmon këtë. /Exlibris



Vilson Kilica

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Drita nuk gabon ndaj Dukagjinit

Drita ka bërë një hap të madh drejtë titullit të kampionit në Superligë, pasi e mposhti Dukagjinitin e Klinës. Fitoreve të dielën u janë edhe Flamurtari dhe Trepça '89 në përballje me Ferizajn dhe Drenicën



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Skuadra e Dritës nga Gjilani vazhdon të jetë e pagabueshme në garën për titull në Superligë, pasi të dielën e mposhti skuadrën e Dukagjinit të Klinës me rezultat 2-0. Në pjesën e parë rastet nuk munguan, por gola nuk pati. Në minutën e 57-të, Drita kaloi në epërsi me golin e shënuar nga Liridon Leci. Ndërsa golin e dytë e shënoi në fund të ndeshjes Astrit Fazliu. Edhe skuadra e Dukagjinit kishte disa mundësi shënimi, por nuk arriti t'i konkretizojë në gol. Pas kësaj xhiro, Drita forcohet në pozitën e parë me 58 pikë, derisa Dukagjini mbetet në vendin e fundit me 10 pikë. Flamurtari i Prishtinës ka vazhduar më formë të mirë në IPKO Superligë, pasi e mposhti Ferizaj me rezultat 3-2. Shend Kelmendi shënoi një gol në pjesën e parë nga penalltia dhe një tjetër gol në pjesën e dytë, kurse shënues tjetër për kuqezinjët ishte edhe Bashkim Shala. Ndërsa për mysafirët shënues ishin Bunjamin Asani dhe Kenan Orana. Flamurtari me tri pikët e reja ka bërë një hap të madh drejtë mbetjes në elitë, pasi tash renditet në pozitën e shtatë me 36 pikë. Ndërsa gjerat për mbijetesë i

komplikohen shumë Ferizaj. Kjo e fundit renditet në vendin e dhjetë me 26 pikë. Në ndeshjen e zhvilluar në Skenderaj mes Drenicës dhe Trepçës '89 janë realizuar gjashtë gola, kurse fituese doli skuadra mysafire me rezultat 2-4. Në pjesën e parë për vendasit shënuan Shillova dhe Hyseni, kurse për mysafirët Avdyli dhe Hoti (2-2). Në pjesën e dytë mysafirët nga Mitrovica ishin skuadër më e mirë dhe arritën fitore falë dy golave që i shënuan Leart Emini dhe Berat Ahmeti. Pas tri pikëve të reja 89-shi ka bërë një hap të madh drejtë mbetjes në elitë, kurse tash renditet në vendin e nëntë me 31 pikë, kurse Drenica është një pozitë më lartë me 35 pikë.

Sot zhvillohen tri ndeshjet tjera

Sot (e hënë) zhvillohen tri ndeshjet e tjera në kuadër të javës së 27-të. Nga ora 17:00 zhvillohet derbi në mes Gjilanit dhe Llapit. Vendasit synojnë tri pikë nga kjo përballje pasi janë në garën për titull, por Llapi edhe përkundër asaj që nuk ka pretendime për titull ka treguar se dinë të jetë klub i rrezikshëm për kundërshtarët. Në kohë të njëjtë zhvillohet edhe ndeshja në mes Ballkanit dhe Vushtrrisë. Klubi që drejtohet nga Ismet Munishi

llogaritet favorit absolut, derisa nga ora 19:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" zhvillohet ndeshja kryesore e kësaj xhiro në mes të Prishtinës dhe Feronikelit.

IPKO SUPERLIGA

Drita - Dukagjini	2-0
Drenica - Trepça '89	2-4
Flamurtari - Ferizaj	3-2

Të hënën takohen:
 17:00 Gjilani - Llapi
 17:00 Ballkani - Vushtrria
 19:00 Prishtina - Feronikeli

Tabela

1. Drita	27	58 pikë
2. Prishtina	26	51
3. Gjilani	26	51
4. Ballkani	26	50
5. Feronikeli	26	44
6. Llapi	26	38
7. Flamurtari	27	36
8. Drenica	27	35
9. Trepça '89	27	31
10. Ferizaj	27	26
11. Vushtrria	26	16
12. Dukagjini	27	10

SHKURT

Mitrovica shpallet kampione e Kosovës

Mitrovica e ka mbrojtur titullin e kampionit në konkurrencën e femrave pasi në ndeshjen përcaktuese e ka mposhtur Feronikelin me rezultat 1:0. Ndeshja është zhvilluar në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë. Golin e fitores për mitrovicaset e ka realizuar Kaltrina Biçkaj në vazhdime, pasi ndeshja në kohën e rregullt ka përfunduar pa gola. Në fund medaljet për ekipin kampion i kanë shpërndarë Xhelal Broja, anëtar i KE të FFK-së dhe Valbona Gashi-Uka, administratore e Ligës së femrave, derisa trofeun e kampionit kapitenes Fatbardha Osmani ia ka dorëzuar anëtarja e KE të FFK-së dhe kryetarja e Komisionit të futbollit të femrave, Vjollca Krasniqi.

Mabetex Prishtina, kampion i futsallit

Mabetex Prishtina është kampion i ri i Kosovës në futsal. Ekipi nga kryeqyteti në ndeshjen finale të "play-off"-it që është zhvilluar në palestrën "Bill Clinton" në Ferizaj e ka mundur Liburnin me rezultat 4:2. Për Mabetex Prishtinën ky ishte trofeu i parë në historinë e klubit.

Shënojnë Rashica dhe Muriqi

Dy reprezentuesit e Kosovës në futboll, Milot Rashica dhe Vedat Muriqi, kanë shënuar gola të shtunën. Rashica ka shkëlqyer në fitoren e Werder Bremenit ndaj Kolnit (6-1). Rashica shënoi golin e dytë dhe ka qenë ndër më të mirët për skuadrën e Bremenit, kurse është zgjedhur edhe në formacionin e javës në Bundesliga. Ndërsa Muriqi ka shënuar golin e parë për Fenerbahçen ndaj Yeni Malatyasporit (3-2).

Beshiktashi e kërkon Taulant Xhakën

Mesfushori i Baselit, Taulant Xhaka, kërkohet nga Beshiktashi. Mediat turke raportojnë se ka pasur kontakte me klubin zviceran për transferimin e lojtarit të kombëtares shqiptare. Xhaka ka edhe një vit kontratë me Baselin dhe normalisht do të duhet të vendosë për të ardhmen e tij, pasi verën e ardhshme do ta humbiste me parametra zero. Beshiktashi tashmë po tenton ta blejë mesfushorin, i cili mund të luajë edhe si mbrojtës qendre, me një çmim të arsyeshëm. Prej verës së vitit 2013 ai është aktivizuar me gjigantin zviceran, klub me të cilin ka fituar pesë herë titullin kampion dhe tri herë Kupën e Zvicrës.

16 basketbollistë rezultojnë të infektuar me Covid-19 në NBA

OLANDO, 28 QERSHOR - NBA-ja ka njoftuar për rezultatet e testimit të 302 basketbollistëve që marrin pjesë në këtë kampionat prestigjioz. Analizat përkatëse kanë zbuluar se 16 prej tyre janë pozi-

tivë. Deri më tani njihen emrat e disa prej të infektuarve me Covid-19, siç janë Nikola Jokiq, Nugget dhe Malcolm Brogdom, Pacers. Të 16 basketbollistët në fjalë duhet të karantinohen për 14

ditë para se t'i kalojnë testet e reja dhe të rivlerësohen nga ana shëndetësore për të parë nëse mund të luajnë në turneun e Orlandos, që pritet të startojë në kompleksin "Disney" nga 30 korriku. Në

fund të qershorit, sipas protokollit të vendosur nga NBA, 22 skuadrat që do të marrin pjesë në Orlando duhet të udhëtojnë drejt Floridas për t'i filluar përgatitjet parsezonale, para se të rifillojë kampionati.



Reja: Lazio i ofron Kumbullës garanci për të luajtur

ROMË, 28 QERSHOR - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Edy Reja, ka dhënë një intervistë për gazetën sportive italiane, "Corriere Dello Sport", ku ka folur për mbrojtësin kuqez të Veronës, Marash Kumbulla, i cili mbetet një nga emrat më të lakuar në tregun e transferimeve në Itali. "Marashi është një mbrojtës shumë inteligjent, shumë i shpejtë në ndërhyrje dhe i fortë në luftën në ajër. Mbi të gjitha, është një djalë me kokën mbi shpatulla, ndaj ka një marzhë shumë të lartë përmirësimi. I ka të gjitha mundësitë për t'u bërë një nga mbrojtësit më të mirë dhe për të luajtur në nivele të larta", ka thënë Reja.

Orët e fundit është folur shumë për një marrëveshje për transferimin e Kumbullës te Lazio, pasi bardhekaltrit kanë arritur një marrëveshje me Veronën, duke "djegur" konkurrencën me Interin, që duke qe avantazhuar për t'i marrë shërbimet e tij. "Nuk besoj se Kumbulla ka



favorizuar një klub apo një tjetër për transferimin. Besoj se vendimi është marrë, apo do të merret duke marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me ofertën ekonomike, por atë profesionale. Kumbulla është një djalosh që dëshiron të luajë vazhdimisht dhe në këtë drejtim Lazio i ofron garanci më të mëdha se të tjerat", ka shtuar Reja.

Mbrojtësi 20-vjeçar ka zgjedhur të luajë për Shqipërinë, ndonëse ka edhe

pasaportë italiane, ndërsa vetë Reja ka deklaruar se Kumbulla mund të ishte një alternativë mjaft e vlefshme për përfaqësuesen e Roberto Mançinit. "Mendoj se mund të kishte interes edhe nga Italia, duke parë edhe faktin që ka pasaportë të vendit tonë. Me cilësitë që ka, është nga të rinjtë më premtues, pasi duhet të pranojmë se, përveç Bastonit, nuk shoh asnjë italian të ri dhe të zonë në mbrojtje, në kampionatin tonë", ka deklaruar Reja.

Chiellini: Totti e meritonte 'Topin e Artë' me shumë se Oweni dhe Shevchenko

TORINO, 28 QERSHOR - Giorgio Chiellini ndoshta e ka publikuar para kohe librin autobiografik "Io, Giorgio". Në të ai shkruan histori të ndryshme dhe mendime për futbollistë që ende vazhdojnë të luajnë, sikurse edhe vetë ai.

Kapiteni i Juventuesit ka prekur një temë që do t'i tërbojë tifozët e Milanit. Bëhet fjalë për "Topin e Artë" që, sipas italianit, duhet ta kishte fituar edhe Francesco Totti. Gjithsesi analogjia që përdor, duke futur në lojë emrat e Owen dhe Shevchenko, me siguri do të hapë polemika në Itali. "Totti mund ta fitonte 'Topin e Artë' përpara se Messi e Ronaldo vendosën diktaktin. Ua kanë dhënë lojtarëve si Owen e Shevchenko, lojtarë të mëdhenj, por sigurisht jo më të mëdhenj se Totti", shkruan Chiellini në librin autobiografik.



SHKURT

Rose dhe Griffin mund të bashkohen te Chicago

Chicago Bulls mund të bëjë një skuadër shumë cilësore për sezonin e ardhshëm. Bulls po lidhet me transferimin e mundshëm të dy emrave të mëdhenj në vitet e fundit në NBA, Derrick Rose dhe Blake Griffin. Organizatori dhe alo-qendra thuhet se mund të bashkohen në konferencën lindore me Bulls. Sipas raportimeve nga ShBA-ja, marrëveshja do të përfshijë emra si Thaddeu Young dhe Otto Porter Jr, për Derrick Rose dhe Griffin. Gjatë edicionit 2018/19 Griffin ka regjistruar një nga sezonet e tij më të mira në aspektin ofensiv, por ka luajtur vetëm 512 minuta në 2019/20. Rose, në anën tjetër, po rigjen ritmin që e kishte dikur, para se të lëndohej. Ky shkëmbim do të ishte 'lotari' për Chicago Bulls.

Robbeni rikthehet nga pensionimi

Arjen Robben edhe zyrtarisht është rikthyer në futboll. Holandezi, pasi u largua nga Bayern Munich, paralajmëroi pensionimin nga futboll, mirëpo ish-ylli i Chelseat dhe Real Madridit është rikthyer pas disa muajsh. Robbeni ka nënshkruar me skuadrën e Groningenit në moshën 36 -vjeçare për sezonin 2020-2021. Një gjë të tillë e ka konfirmuar edhe vetë klubi holandez në faqen zyrtare.

Tevezi: Në ndeshjen time të lamtumirës dua Ronaldon dhe Messin

Carlos Tevez po merr në konsideratë idenë për t'u tërhequr nga futboll. Sikundër deklaroi në një intervistë për "Radio la Red", qendërsulmuesi argjentinas është ende në mëdyshje për atë që do të bëjë vitin e ardhshëm, kur do t'i përfundojë kontrata me Bocën, të cilën do ta rinovojë edhe për gjashtë muaj. Gjatë intervistës, "Apashi" ka folur për një ndeshje lamtumire dhe lojtarët që do të pëlqente të kishte në krah. "Do t'i thërrisja Buffonin, Ibarrën, Ferdinandin, Haizen dhe Evranë. Në mes-fushë Pirlon, Scholesin dhe Pogban ndërsa në sulm Ronaldon, Messin dhe Rooneyn". Kaq ka mjaftuar që të gjithë të ëndërronjë të shohin bashkë në fushë qoftë dhe për një miqësore CR7 dhe "Pleshtin".

Mbappe: Më mungon shumë Buffoni

Duket se largimi i Gianluigi Buffonit nga PSG-ja, ka lënë gjurmë te Kylian Mbappe. Në një intervistë për "L'Equipe", sulmuesi francez është shprehur se largimi i Buffonit nuk ishte i lehtë për të. Buffoni dhe Mbappe ishin shokë skuadre në klubin francez gjatë sezonit futbollistik 2018-19, ku së bashku fituan Ligën 1. Mirëpo, 41-vjeçari vendosi të kthehej te Juve verën e kaluar dhe sulmuesi pranon se ai ishte shumë i rëndësishëm për të. "Gjithmonë jam i prirë për t'i dëgjuar 'pleqtë'. Buffoni, gjithashtu, ishte shumë i rëndësishëm për mua. Kam mësuar shumë prej tij. Unë kam qenë shumë i lidhur me Lassana Diarra dhe largimi i tij ishte tronditës për mua. Të njëjtin efekt pati edhe ai i Buffonit", ka thënë Mbappe.

Liverpooli me ngulmë kërkon transferimin e Koulibalyt

Skuadra kampione e Premierë Ligës, Liverpooli, po tenton që të mbyllë sa më parë marrëveshjen për transferimin e Kalidou Koulibalyt nga Napoli. "The Reds" ka kohë që është futur në garë për transferimin e mbrojtësit senegalez, mirëpo napolitanët kërkojnë shumë. Sipas asaj që raporton "Tuttomercatoweb", Liverpooli do të bëjë ofertë për Koulibalyt në ditët e ardhshme. Jurgen Kloppi e dëshiron transferimin e mbrojtësit 29-vjeçar për të ndërtuar një partneritet më të fuqishëm në mbrojtje me Virgil Van Dijkun. Napoli kërkon 120 milionë euro për ta lënë mbrojtësin të largohet nga San Polo, derisa Liverpooli nuk ofron më shumë se 100 milionë.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588

+381(0)390/324 034

www.cabrati.com

e-mail. info@cabrati.com

Gjakovë - Gjakova

K.R.M. "ÇABRATI"

Bordi i Drejtorëve të KRM "Çabrati" Sh.A., në mbledhjen e mbajtur me datë 26.06.2020, nxjerrë këtë

NJOFTIM:

1. Anulohet konkursi për Kryeshef Ekzekutiv të KRM "Çabrati" Sh.A., i shpallur me datë 09.06.2020.
2. Anulimi i konkursit bëhet për arsye të mungesës së kuorumit, të Bordit.
3. Konkursi do të rishpallet sapo të plotësohet numri i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve



Kompania Rajonale e Ujësllësit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

29.06.2020

NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURISIT

Komisionit i Auditimit të Brendshëm i K.R.U-Gjakova Sh.a, anulon konkursin e shpallur në gazetën Epoka e re fq.23 për pozitën: **Drejtor/e i/e Njësisë së Auditimit të Brendshëm** i publikuar me datë 20.06.2020 në rubriken- shpallje (Portali- Online).

Konkursi është anuluar duke u bazuar në Nenin 6 pika 5.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik i cili përcakton se konkursi duhet të përsëritet : kur së paku tre kandidatë nuk i plotësojnë kushtet e parapara në konkurs.

Komisioni Për Auditim të Brendshëm i

KRU-GJAKOVA SH.A

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Valentin Juriku shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Leke Dugagjini " Prizren.

► Qendrim Nervoja shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.

► Haki Ramadani shpall të pavlefshme dëftesat certifikatën diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m2, e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e 1 (një) anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues nga shoqëria civile

Në pajtim me nenin 9 dhe 10 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor për zgjedhjen e anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, Kuvendi shpall konkurs për plotësimin e pozitës:

1 (një) anëtar/e, përfaqësues nga shoqëria civile.

I. Kandidati për anëtar në Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. Të jetë shtetas dhe banor i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë përgatitje të lartë profesionale nga fusha e drejtësisë;
3. Të ketë njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut;
4. Të ketë përvojë pune në çështjet ligjore së paku 5 (pesë) vjet;
5. Të ketë përkrahjen e së paku 5 (pesë) organizatave të shoqërisë civile të fushës së drejtësisë;
6. Të mos jetë i dënuar për vepër penale.

II. Shoqëria civile duhet t'i bashkëngjisë listës së kandidatëve të nominuar për anëtar edhe dokumentet, të cilat vërtetojnë se kandidati i plotëson kushtet e paraqitura në këtë shpallje publike.

III. Kuvendi i Kosovës inkurajon shoqërinë civile, që gjatë dërgimit të propozimeve për anëtar të KPK-së, të marrë parasysh përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuar të barazisë gjinore.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më **13.07.2020, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:

Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217);

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038/ 211-182, 038/ 211-648 dhe 044/ 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosova rishpall:

KONKURS

Za izbor jednog (1) člana Tužilačkog saveta Kosova, predstavnik civilnog društva

Na osnovu člana 9. i 10. Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova i u cilju ispunjavanja zakonske obaveze za izbor člana Tužilačkog saveta Kosova, Skupština raspisuje konkurs za popunjavanje položaja:

1 (jedan) član/ica, predstavnik civilnog društva.

II. Kandidat za člana Tužilačkog saveta Republike Kosova, dužan je da ispuni sledeće uslove:

1. Da je državljanin i stanovnik Republike Kosova;
2. Da poseduje visoku stručnu spremu iz oblasti prava;
3. Da poseduje znanje iz oblasti ljudskih prava;
4. Da ima radno iskustvo o pravnim pitanjima, najmanje 5 (pet) godina;
5. Da ima podršku najmanje 5 (pet) organizacija civilnog društva iz oblasti pravosuđa;
6. Da nije kažnjavan za krivično delo.

II. Civilno društvo dužno je da priloži listi nominiranih kandidata za člana i dokumenta, koja dokazuju da kandidat ispunjava uslove navedene u ovom javnom konkursu.

III. Skupština Kosova podstiče civilno društvo da tokom dostavljanja predloga za člana TSK-a, uzme u obzir multietnički sastav Republike Kosova i priznata načela rodne ravnopravnosti.

Aplikaciji priložiti sledeća prateća dokumenta:

- Autobiografija (Curriculum Vitae);
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi (diplome Univerziteta van zemlje, moraju biti nostrifikovane od strane Ministarstva obrazovanja, nauke i tehnologije);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije kažnjavan za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 13.07.2020. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:

Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038/211-182, 038/ 211-648 i 044/ 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta.

Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

